



Rezultatet e anketës

Njohuritë dhe perceptimet e publikut për të shkuarën komuniste në Shqipëri dhe pritshmëritë e tyre për të ardhmen



The background is a solid teal color. Overlaid on this are several abstract, interconnected lines in white, light green, and dark red. The lines form a complex, non-representational pattern that suggests movement and structure. The white lines are the most prominent, forming a large, irregular shape that occupies much of the left and bottom portions of the page. The green lines are thinner and more delicate, weaving through the white lines. The red lines are also thin and form smaller, more localized shapes, primarily in the middle-left area.

Prezantimi
i rezultateve
të anketës

Njohuritë dhe perceptimet
e publikut për të shkuarën
komuniste në Shqipëri
dhe pritshmëritë e tyre
për të ardhmen

Anketa “Njohuritë dhe perceptimet e publikut për të shkuarën komuniste në Shqipëri dhe pritshmëritë e tyre për të ardhmen,” e cila u zhvillua në shtator të vitit 2015 nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA), është pjesë e projektit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri “Platforma e dialogut kombëtar rreth shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë regjimit të mëparshëm komunist në Shqipëri,” zbatuar me mbështetjen e Republikës Federale të Gjermanisë. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmëri ato të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri .

© **Prezenca
e OSBE-së në
Shqipëri, 2016**

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Materiali që përmban ky publikim mund të citohet ose rishtypet me kusht që të njihet autorësia e tij dhe një kopje e publikimit që përmban materialin e rishtypur t’i dërgohet OSBE-së. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por që nuk kufizohet në përdorimin komercial apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky publikim, kërkon lejen me shkrim të OSBE-së.

**Instituti
për Kërkime dhe
Alternativa
Zhvillimi – IDRA**

IDRA është forum i pavarur, jofitimprurës dhe joqeveritar i krijuar në vitin 2000 nga një grup kërkuesish me përvojë. Instituti përkrah vlerat e lirisë dhe demokracisë, ekonominë e tregut të lirë dhe shoqërinë civile, duke i shërbyer në vazhdimësi demokratizimit të shoqërisë shqiptare dhe procesit të integritimit në Bashkimin Evropian. Misioni i IDRA-s është të shërbejë si institut që ofron ekspertizë dhe si urë e efektshme ndërmjet publikut dhe institucioneve, duke qenë e vëmendshme për problemet me të cilat përballet shoqëria shqiptare dhe duke rritur bashkëpunimin dhe dialogun në mënyrë të paanshme, etike dhe profesionale.

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4
HISTORIKU DHE OBJEKTIVAT	5
Historiku i projektit	5
Objektivat e anketës	5
METODOLOGJIA	6
Kampionimi	8
Analiza	8
A. Moshë	8
B. Gjinia	9
C. Arsimi	9
D. Pozicioni ose rezidenca gjeografike	9
E. Nëse të anketuarit janë persekutuar apo burgosur nga regjimi	10
GJETJET KRYESORE	12
A është problem e shkuara komuniste e Shqipërisë?	14
Trajtimi i të shkuarës komuniste	16
A. Hapja e dosjeve të sigurimit	16
B. Lustracioni	36
C. Të mësuarit rreth së shkuarës	37
D. Falja	40
E. Vendet e kujtesës	41
Njohuri për të shkuarën komuniste të Shqipërisë	40
A. Vlerësim vetjak të nivelit të përgjithshëm të njohurive	43
B. Njohuri për disa veçori të jetës gjatë komunizmit	46
C. Njohuri për disa aspekte të jetës politike gjatë komunizmit	51
D. Informimi rreth të persekutuarve	56
Perceptimet rreth regjimit komunist të Shqipërisë	55
A. Perceptimet rreth komunizmit shqiptar	57
B. Standardi i jetesës	62
C. Barazia gjinore	63
D. Perceptimet për disa figura publike nga epoka komuniste	67
PËRFUNDIME	72
Shtojcë	76

Kjo anketë vjen në vijimin e përpjekjeve të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri (Prezenca) për të mbështetur një platformë të depolitizuar diskutimi për të shkuarën komuniste të Shqipërisë, me qëllim përfundimtar informimin e shoqërisë shqiptare dhe përgatitjen për të trajtuar historinë e vendit gjatë diktaturës komuniste. Konkretisht, me anë të kësaj ankete synohet të ofrohen të dhëna të reja rreth mënyrës se si shqiptarët e shohin të shkuarën komuniste të Shqipërisë, çfarë dinë ata në të vërtetë për regjimin e mëparshëm dhe çfarë duan apo presin prej përpjekjeve për të trajtuar trashëgiminë e së shkuarës. Prezenca është përqendruar veçanërisht tek perceptimet dhe pritshmëritë e qytetarëve në lidhje me hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit. Procesi i hapjes së dosjeve nisi në vitin 2015 me miratimin e ligjit për krijimin e një organi shtetëror përgjegjës për kryerjen e këtij procesi. Në kohën e botimit të këtij materiali, ligji ende nuk është zbatuar plotësisht.

Studimi u krye me kampion kombëtar përfaqësues prej 995 personash, të cilët u intervistuan ballë për ballë. Rezultatet janë të ndara sipas moshës, gjinisë, arsimit, vendbanimit dhe statusit si ish të persekutuar apo ish të burgosur. Pyetjet u përcaktuan bashkërisht nga Prezenca dhe Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA), me kontributin, veçanërisht në lidhje me vendet e kujtesës edhe të Trashëgimia Kulturore pa Kufij.

Prezantimi i gjetjeve kryesore ndahet në katër pjesë. Pjesa e parë prezanton rezultatet në lidhje me perceptimet për trashëgiminë e komunizmit si problem aktual dhe ndiqet nga pjesa e dytë që përmban gjetjet rreth pritshmërisë dhe shqetësimeve në lidhje me mënyrat e ndryshme të mundshme për të trajtuar të shkuarën komuniste. Pjesa e tretë ofron rezultatet në lidhje me njohuritë rreth regjimit të mëparshëm dhe pjesa e katërt përmban të dhëna rreth perceptimeve për regjimin komunist të Shqipërisë dhe jetesës gjatë asaj periudhe.

Në fund, Prezenca ka nxjerrë disa përfundime nga të dhënat. Në përgjithësi, qytetarët nuk e shohin trashëgiminë e së shkuarës komuniste në Shqipëri si problem të madh për vendin sot, sidomos krahasuar me çështje si ekonomia, korrupsioni dhe keqqeverisja. Megjithatë, rezultatet tregojnë se qytetarët mbështesin hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit dhe janë shumë të interesuar për procesin e lustracionit.

Në lidhje me njohuritë për regjimin e mëparshëm, të rinjtë dinë më pak rreth tipareve të komunizmit në Shqipëri në krahasim me më të moshuarit. Gjithashtu duket se në përgjithësi qytetarët që jetojnë në veri kanë më pak informacion për regjimin e mëparshëm. Sidoqoftë, në përgjithësi, ata kanë njohuri të mira për tiparet kryesore të jetesës gjatë periudhës së komunizmit. Një element interesant për tu marrë parasysh është roli mbizotërues i televizionit në të mësuarit e qytetarëve për të shkuarën komuniste, ndërsa shkollat duket se kanë pasur rol shumë të kufizuar. Në lidhje me perceptimet, të dhënat tregojnë se nuk ekziston një perceptim i vetëm për regjimin komunist dhe se do të ishte gabim të hamendësohej se të gjithë shqiptarët e shohin komunizmin si diçka negative. Gati gjysma e të anketuarve mendojnë se komunizmi në Shqipëri ishte “një ide e mirë e cila u zbatua keq”, por ka mendime të ndryshme, dhe për jetën gjatë periudhës së komunizmit nuk ekziston një perceptim i vetëm. Shumica e të anketuarve mendojnë se të paktën disa aspekte të jetës ishin më mirë gjatë regjimit të tilla si: aspekte si siguria, arsimit dhe punësimi. Aspektet e jetës që të anketuarit mendojnë se ishin më të këqija gjatë regjimit janë zhvillimi ekonomik, mungesa e lirisë dhe shkelja e të drejtave të njeriut. Ekziston një ndasi e dukshme ndërmjet të anketuarve në lidhje me perceptimin për rolin e Enver Hoxhës në historinë e Shqipërisë, që shihet si pozitiv nga gati gjysma e të anketuarve dhe si negativ nga gjysma tjetër. Mendimet ishin gjithashtu të ndara rreth figurave të tjera të spikatura të kohës së komunizmit si Nexhmije Hoxha dhe Ramiz Alia.

Panorama që del nga të dhënat është e ndërlikuar dhe është e rëndësishme të shqyrtohen me kujdes variacionet që ekzistojnë ndërmjet popullatës dhe jo thjeshtë të përdoren si bazë gjetjet e pandara sipas kategorive. Vërtetë që ka dallime të dukshme njohurish, perceptimesh dhe pritshmërisht ndërmjet personave që i përkasin gjinive, moshave, niveleve arsimore dhe vendbanimeve të ndryshme si dhe ndërmjet atyre që kanë vuajtur persekutimin dhe atyre që nuk e kanë vuajtur atë. Një gjë e tillë e thekson më tej nevojën për një qasje të shumëngjyrshme dhe gjithëpërfshirëse gjatë përpjekjeve për të trajtuar të shkuarën komuniste në Shqipëri.



A. Historiku i projektit

Anketa "Njohuritë dhe perceptimet e publikut për të shkuarën komuniste në Shqipëri dhe pritshmëritë e tyre për të ardhmen" e zhvilluar në shtator të vitit 2015 nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA), është pjesë e projektit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri "Platforma e dialogut kombëtar rreth shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë

regjimit të mëparshëm komunist në Shqipëri" zbatuar me mbështetjen e Republikës Federale të Gjermanisë. Ky projekt synon të mbështesë një platformë të depolitizuar diskutimi për të shkuarën komuniste të Shqipërisë, me qëllim përfundimtar informimin e shoqërisë shqiptare dhe përgatitjen për të trajtuar historinë e vendit gjatë diktaturës komuniste.

B. Objektivat e anketës



Anketa përqendrohet në mbledhjen e informacioneve të reja rreth:

- Pikëpamjes së publikut për mënyrat e ndryshme sipas të cilave Shqipëria mund të "përballet me të shkuarën," duke u përqendruar veçanërisht në hapjen e dosjeve të shërbimit sekret gjatë regjimit të mëparshëm;
- Njohuritë e publikut rreth periudhës komuniste në Shqipëri, të ndara sipas moshës, gjinisë, dhe pozicionit gjeografik, për të parë nëse ka ndryshime;
- Perceptimet rreth periudhës komuniste, gjithashtu të ndara sipas moshës, gjinisë, dhe pozicionit gjeografik.


Prezenca do t'i përdorë këto të dhëna për të qenë e informuar gjatë punës së saj të vazhdueshme për të

mbështetur dialogun gjithëpërfshirës kombëtar për trajtimin e së shkuarës komuniste të Shqipërisë. Shpresohet se këto të dhëna do të jenë të dobishme dhe për subjektet e tjera që trajtojnë këtë fushë, si: politikëbërësit, organizatat e shoqërisë civile, kërkuesit e fushës akademike, etj.

Sidoqoftë, kjo anketë ka diapazon të kufizuar dhe duhen mbledhur ende shumë informacione të tjera për të pasur një panoramë të plotë të kësaj çështjeje të ndërlikuar. Gjithashtu, këto të dhëna shpërndahen pa kryer analiza të mëtejshme në mënyrë që subjektet e interesuar të vlerësojnë dhe të marrin parasysh vetë se çfarë nënkuptojnë këto të dhëna sipas fushës së tyre të ekspertizës. Nevojiten kërkime të mëtejshme për të shqyrtuar arsyet e rezultateve të ndryshme që prezantohen në këtë raport.



00:00





METODOLOGJIA



A. KAMPIONIMI

U zhvillua një anketë kombëtare me pjesëmarrjen e 995 personave mbi moshën 16 vjeç. Përzgjedhja e të anketuarve u krye sipas një procesi me disa faza. Qendrat e votimit të caktuara gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare të vitit 2013 shërbyen si njësi parësore kampionimi, duke përdorur një formulë që gjeneron numra të rastësishëm, dhe duke marrë parasysh numrin e votuesve në secilën qendër votimi si dhe dimensionin urban kundrejt atij rural. Të anketuarit u përzgjedhën në mënyrë rastësore brenda zonave të

përcaktuara nga këto njësi. U përzgjedh çdo derë e tretë nga e djathta dhe u intervistua personi më i ri i shtëpisë me moshë më të madhe se 16 vjeç.

Marzhi i gabimit për kampionin e përdorur në anketë është $\pm 3.1\%$, me diapazon besueshmërie 95%. Kjo do të thotë se nëse do të përsëritej anketa me të njëjtin kampion, 95% e tyre do të pasqyronte të dhëna nga kampioni i përzgjedhur pasaktësisht e të cilave nuk do kalonte $\pm 3.1\%$.

B. ANALIZA

Përgjatë grumbullimit të të dhënave, u përdorën nivele të ndryshme vlerësimi, në mënyrë që përgjigjet për pyetjet e ndryshme të jepeshin p.sh. nga 1 në 4, 1 në 5, apo 1 në 10. Për të lehtësuar përlogaritjen gjatë procesimit, këto nivele vlerësimi u kthyen në nivel nga 0 në 100 sipas formulës së mëposhtme:

$$C = \frac{(E - 1)}{(n - 1)} \times 100$$

E – përgjigjja/vlerësimi sipas nivelit fillestar të vlerësimit

C – vlera e kthyer

n – numri i niveleve të vlerësimit

Gjithashtu, analiza lejonte ndarjen e të dhënave sipas faktorëve të mëposhtëm.

1. Moshë

Kampioni kategorizohet në tre tri grupmosha:

16 – 35 vjeç

Të anketuarit, pjesë e kësaj kategorie të kampionit, kanë lindur gjatë periudhës së demokracisë ose kanë jetuar shkurtimisht gjatë periudhës komuniste në Shqipëri, kur ishin të vegjël.


36 – 55 vjeç

Të anketuarit, pjesë e kësaj kategorie të kampionit, kanë përvojë më të gjatë me periudhën komuniste në Shqipëri, kryesisht në moshë të re.

Mbi 55 vjeç

Të anketuarit, pjesë e kësaj kategorie, kanë përvojë të plotë me periudhën komuniste në Shqipëri.

Përgjigjet sipas moshës



2. Gjinia

Gratë përfaqësojnë shumicën e të anketuarve, në nivelin 61%, ndërsa burrat përfaqësojnë vetëm 39%.

Në analizën e pandarë sipas kategorive, përgjigjet e dhëna nga gratë morën më pak peshë për të pasqyruar shpërndarjen gjinore aktuale në Shqipëri (burra=50% dhe gra =50%).


Përgjigjet sipas gjinisë



3. Arsimi

Për qëllim të anketës, niveli arsimor është ndarë në katër kategori: arsim 8-vjeçar i papërfunduar, arsim 8-vjeçar, arsim i mesëm dhe arsim i lartë. Numri i të anketuarve pa arsim

8-vjeçar dhe atyre me arsim pasuniversitar ishte shumë i vogël për të qenë përfaqësues, prandaj janë hequr nga qëllimi i analizës.




4. Pozicioni ose rezidenca gjeografike

Rajonet u ndanë si më poshtë:

- Rajoni Jug/Jug-perëndim (Berat, Fier, Gjirokastrë & Vlorë) që përbën 26% të intervistave
- Rajoni Jug-lindje (Elbasan, Korçë) që përbën 19% të intervistave

- Rajoni Verior (Dibër, Kukës, Lezhë, Shkodër) që përbën 27% të intervistave
- Rajoni Qendror (Durrës, Tiranë) që përbën 28% të intervistave




5. Nëse të anketuarit janë persekutuar apo burgosur nga regjimi


Persekutimi ose burgosja e të persektuarve u pohua me vetëdeklarim dhe intervistuesit nuk verifikuan apo shqyrtuan më tej historitë e persekutimit të të anketuarve. Ka vlerë të theksohet se burgosja gjatë regjimit të mëparshëm nuk ishte detyrimisht politike dhe perceptimi se çfarë është persekutimi varet nga i anketuari. Në këtë anketë, 197 nga

995 të anketuar raportuan të kenë qenë të persektuar gjatë komunizmit (persektim të drejtpërdrejt apo persektim të të afërmeve të tyre), çka përbën 20% të të gjithë të anketuarve. Rajoni verior kishte përqindjen më të lartë të personave të persektuar, në krahasim me rajonet e tjera.

Njerëzit që kanë përjetuar persekutimin përgjatë komunizmit







GJETJET KRYESORE






A. A ËSHTË PROBLEM E SHKUARA KOMUNISTE E SHQIPËRISË?

Të anketuarve iu kërkua të rendisin çështje të ndryshme bazuar në problematikat që ato shfaqin, për të vlerësuar krahasimisht problematikën e të shkuarës komuniste në krahasim me problemet e tjera me të cilat përballen qytetarët shqiptarë. Shumica e të anketuarve përmendi çështjet e mëposhtme si "problem të madh": arsimin, shëndetësinë, korrupsionin/keqqeverisjen, pandëshkueshmërinë,

ekonominë dhe ndotjen e mjedisit. Rendi/siguria shihej në përgjithësi si më pak problematike, por sidoqoftë më problematike se trashëgimia e së shkuarës komuniste. Çështja që shihej si më pak problematike është terrorizmi/radikalizmi fetar. Në përgjithësi, kjo tregon se e shkuara komuniste renditet shumë prapa shqetësimeve të tjera të shqiptarëve.







Ndërsa 62% e të anketuarve mendojnë se e shkuara komuniste është të paktën disi problematike, 35% mendojnë se trashëgimia e komunizmit në Shqipëri nuk është aspak problem. Vlen të theksohet se të anketuarve nuk iu dha një përkufizim i “trashëgimisë së komunizmit” dhe përgjigjet u dhanë në bazë të perceptimit të të anketuarve rreth

përmbajtjes së kësaj trashëgimie. Të persekutuarit kishin më shumë gjasa të shihnin trashëgiminë komuniste si “problem të madh” (31%) në krahasim me popullatën e përgjithshme (vetëm 19%). Sidoqoftë, gati e njëjta përqindje e personave të persekutuar dhe jo të persekutuar mendonin se kjo e shkuar nuk përbën aspak problem.

Sa problem mendoni se është trashëgimia e të shkuarës komuniste në Shqipëri?



Sa problem mendoni se është trashëgimia e të shkuarës komuniste në Shqipëri?



B. TRAJTIMI I TË SHKUARËS KOMUNISTE


Anketa reflekton perceptimin e të anketuarve rreth disa përgjigjeve me zgjedhje, në kuadër të asaj që Prezenca quan "trajtimit të shkuarës komuniste." Patjetër që kjo listë nuk është shteruese dhe përgjigjet me zgjedhje nuk prezantohen në ndonjë rend të veçantë. Për qëllim të kësaj ankete, një aspekt i veçantë i trajtimit të të shkuarës gëzoi më shumë vëmendje: hapja e dosjeve të ish-sigurimit. Ligji për hapjen e dosjeve u miratua në mars të vitit 2015, vetëm gjashtë muaj përpara se të kryhej anketa. Prezenca ishte veçanërisht e

interesuar për perceptimin e qytetarëve rreth këtij ligji dhe ndikimin e tij të mundshëm për vendin, përderisa miratimi i ligjit u shoqërua me debate të mëdha. Ndërmjet të anketuarve, 20% raportuan se janë persekutuar gjatë komunizmit (qoftë persekutim të drejtpërdrejt ose persekutim të të afërmeve të tyre). Prezenca ishte veçanërisht e interesuar të mblidhte informacione rreth mënyrës se si të persekutuuarit i shohin zhvillimet në lidhje me hapjen e dosjeve.

1. Hapja e dosjeve të sigurimit

Njohuritë rreth ligjit për hapjen e dosjeve


Të pyetur nëse kanë dijeni që është miratuar ligji për të drejtën e informimit për dosjet sekrete të ish-Sigurimit në Shqipëri, pak më shumë se gjysma (53%) e të anketuarve thanë "po". Kishte më shumë burra që e dinin një gjë të tillë (61%) sesa gra (vetëm 45%).



Të anketuarit në veri kishin më pak gjasa të dinin një gjë të tillë (vetëm 36%), ndërsa të anketuarit në Jug-lindje përbënin

përqindjen më të madhe të të anketuarve sipas rajonit që dinin rreth ligjit (66%).


A jeni në dijeni të ndonjë ligji të miratuar së fundi për të drejtën e publikut për t'u informuar për dosjet sekrete të ish-sigurimit të shtetit në Shqipëri?




Nga të anketuarit që kanë dijeni për miratimin e ligjit për hapjen e dosjeve, 59% deklarojnë se janë shumë të informuar rreth ligjit. Kjo do të thotë se nga të anketuarit

që kanë dëgjuar për ligjin, 41% nuk kanë njohuri rreth përmbajtjes. Vetëm 12% e të anketuarve që kanë dijeni për miratimin e ligjit, e kanë lexuar atë.

Sa të informuar mendoni se jeni për këtë ligj? (për ata të cilët kanë dijeni)



A e keni lexuar ligjin për hapjen e dosjeve sekrete të ish-Sigurimit në Shqipëri?




Në përgjithësi, duket se të persekutuarit nuk janë dukshëm më të informuar rreth ligjit për hapjen e dosjeve, por duken shumë më të interesuar dhe të prekur nga ligji. Të dhënat e anketës tregojnë se 59% e të anketuarve që kanë vuajtur persekutimin janë në dijeni të ligjit të miratuar së fundmi për të drejtën e informimit për dosjet e Sigurimit në Shqipëri. Ky nuk është nivel shumë me i lartë ndërgjegjësimit krahasuar me popullatën e përgjithshme, duke qenë se 53% e të gjithë të anketuarve kanë dijeni për ligjin. Ata nuk janë as shumë më të informuar për përmbajtjen e ligjit, pasi 68% e të perse-

kutuarve të anketuar që kanë dijeni për ligjin janë të informuar rreth përmbajtjes së tij dhe 59% e të anketuarve nga popullsia e përgjithshme që kanë dijeni për ligjin e shohin veten të informuar rreth përmbajtjes së tij.


Nga ana tjetër, 27% e të persekutuarve që kanë dijeni për ligjin pohojnë se e kanë lexuar atë, çka tregon interes apo akses më të madh në informacion për ligjin krahasuar me publikun e përgjithshëm, ku vetëm 12% e atyre që kanë dijeni për ligjin e kanë lexuar atë.




A jeni në dijeni të ndonjë ligji të miratuar për të drejtën e publikut për t'u informuar për dosjet sekrete të ish-Sigurimit të shtetit në Shqipëri?




Sa të informuar mendoni se jeni për këtë ligj?



Cila nga këto pohime vlen për ju personalisht, lidhur me dosjet sekrete të ish-Sigurimit?



A e keni lexuar ligjin për hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit të shtetit në Shqipëri?




Interesimi rreth hapjes së dosjeve

Hapja e dosjeve sekrete të Sigurimit të regjimit komunist në Shqipëri duket se nuk ngacmon interesin e shumicës, pasi vetëm 37% e të anketuarve u përgjigjën se janë të interesuar rreth kësaj çështjeje. Më shumë se gjysma e të anketuarve (55%) pohojnë se thjesht nuk kanë qenë kurrë të interesuar për dosjet dhe vazhdojnë të mos jenë të interesuar, ndërsa 8% pohojnë se kanë qenë të interesuar më parë, por nuk


janë më. Ia vlen të merret parasysh se gati çereku i të anketuarve (24%) thonë se nuk kanë qenë të interesuar më parë, por janë të interesuar tani – kjo shifër të bën të mendosh se miratimi i ligjit së fundmi përkon me një rritje të lehtë të interesit për këtë temë. Gratë tregojnë pak më pak interes për hapjen e dosjeve në krahasim me burrat – vetëm 34% janë të interesuara, krahasuar me 40% të burrave.

Cila nga këto pohime lidhur me hapjen e dosjeve të komunizmit vlen për ju personalisht?



Kur të dhënat ndahen sipas arsimit, duket se ka rritje të lehtë të interesimit me rritjen e nivelit të arsimit, sidoqoftë dallimet nuk janë të mëdha.


Cila nga këto pohime lidhur me hapjen e dosjeve të komunizmit vlen për ju personalisht?



Të anketuarit u pyetën gjithashtu rreth rëndësisë së ligjit për hapjen e dosjeve të ish sigurimit, si për Shqipërinë dhe për ta personalisht. Duket se publiku e sheh këtë ligj më të rëndësishëm për Shqipërinë se sa për ata personalisht. Mbi dy të tretat e të anketuarve (69%) deklaruan që ligji për hapjen e dosjeve të ish-sigurimit është i rëndësishëm për Shqipërinë – qoftë “disi i rëndësishëm” (37%) ose “shumë i

rëndësishëm” (32%). Sidoqoftë, një përqindje shumë më e vogël, afërsisht gjysma e të anketuarve, mendon se hapja e dosjeve është e rëndësishme për ta personalisht. Gjithashtu, përqindja e personave që mendojnë se ky ligj është “shumë i rëndësishëm” për Shqipërinë (32%) është gati sa dyfishi i përqindjes së atyre që mendojnë se ligji është “shumë i rëndësishëm” për ta personalisht (vetëm 17%).


Sa i rëndësishëm mendoni se është për Shqipërinë ligji i hapjes së dosjeve të ish-Sigurimit? (sipas gjinisë)




GJETJET KRYESORE

Sipas grupmohave, ligji shihej si më i rëndësishëm personalisht nga personat me moshë më të madhe se sa të rinjtë.

Sa i rëndësishëm është për ju personalisht, ligji për hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit?




Sa i rëndësishëm është për ju personalisht, ligji për hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit?



Përveç nivelit të interesit të raportuar nga vetë të anketuarit, ja vlen gjithashtu të shihet nëse ata besojnë se ligji ka ndikim mbi ta. Sidoqoftë, të pyetur nëse në dosjet e ish-sigurimit ndodhet ndonjë material që ka të bëjë me ta apo me të afërmit e tyre, gati gjysma e të anketuarve (45%) janë të sigurt se nuk ka të tilla, ndërsa pak prej tyre (7%) janë të bindur se

ka. Nga të anketuarit, 49% u përgjigjën se nuk e dinë, por shumica e atyre që nuk e dinë nuk janë të interesuar për ta zbuluar. Vetëm 11% e të gjithë të anketuarve që nuk e dinë janë të interesuar ta zbulojnë.


A e dini nëse ka materiale të lidhur me ju personalisht ose me familjarët tuaj të afërt në dosjet e ish-Sigurimit? (sipas gjinisë)



Në lidhje me ekzistencën e materialeve rreth tyre apo të afërmeve të tyre në dosjet e ish-sigurimit, një përqindje shumë më e lartë e të persektuarve janë të sigurt se ka – plot 27%, krahasuar me vetëm 7% të popullatës së përgjithshme. Ndërsa gati gjysma e të anketuarve nga popullata e përgjithshme (45%) janë të sigurt se nuk ka

informacione të tilla, kjo shifër është shumë më e ulët për të persektuarit, ku 24% e tyre janë të sigurt se dosjet nuk përmbajnë informacione për ta. Ja vlen të kihet parasysh se 28% e të persektuarve nuk e dinë nëse ka materiale të tilla dhe nuk janë të interesuar për ta zbuluar (krahasuar me 29% të popullatës së përgjithshme).

A e dini nëse ka materiale të lidhur me ju personalisht ose me familjarët tuaj të afërt në dosjet e ish-Sigurimit?



Të pyetur nëse dëshirojnë të shohin dokumentet e ish-Sigurimit që kanë të bëjnë me ta, nëse zbulojnë se ka të tilla, të anketuarit japin përgjigje të ndryshme. Gjysma e të anketuarve (50%) thonë se kanë dëshirë t'i shikojnë këto


dokumente, 44% nuk janë të interesuar, kurse 6% nuk e dinë. Nuk ka dallime të dukshme midis përgjigjeve të burrave dhe grave për këtë pyetje. Ndarë sipas rajonit, pjesa qendrore ka përqindje më të lartë personash të cilët dëshirojnë t'i shohin

GJETJET KRYESORE


dokumentet që kanë të bëjnë me ta, nëse ka të tilla, krahasuar me mesataren. Ndryshe nga kjo, të anketuarit në Jug-Jug-perëndim kanë përqindje më lartë personash që thonë se nuk do t'i shihnin ato dosje, krahasuar me mesataren. Po t'i ndajmë rezultatet sipas nivelit arsimor, duket se ata me arsim universitar kanë më gjasa të duan të shohin dosjet, nëse ka

të tilla, krahasuar me personat me nivel më të ulët arsimor. Gjithashtu, një përqindje shumë më e lartë e personave të persekutuar janë të interesuar të shqyrtojnë çfarëdolloj dosjeje (65%) krahasuar me personat që nuk kanë vuajtur persekutimin (vetëm 47%).


Në rast se zbuloni se ka të tilla, a do të donit të njiheshit me dokumentet, që lidhen me ju në dosjet e ish-Sigurimit? (sipas gjinisë)




Në rast se zbuloni se dokumente të tilla ekzistojnë a do të donit të njiheshit me to?



Në rast se zbuloni se dokumente të tilla ekzistojnë a do të donit të njiheshit me to?




Në rast se zbuloni se dokumente të tilla ekzistojnë a do të donit të njiheshit me to?



Të pyetur nëse do të paraqiteshin tek Autoriteti për të kontrolluar nëse ka materiale që kanë të bëjnë me ta apo me të

afërmit e tyre, rreth një e treta e të anketuarve pohoi një gjë të tillë.


A do të paraqiteshit para autoritetit përgjegjës për hapjen e dosjeve për të kontrolluar nëse ka ndonjë material për ju apo për të afërmit tuaj?



Rezultatet e anketës tregojnë se gati gjysma (47%) e të anketuarve të persekutuar pohuan se do t'i qaseshin autoritetit përgjegjës për hapjen e dosjeve për të parë nëse ka materiale rreth tyre apo të afërmeve të tyre. Kjo shifër

është dukshëm më e lartë se sa përqindja e të anketuarve nga popullata e përgjithshme (29%) të cilët pohuan se do të viheshin në kërkim të një informacioni të tillë.


A do të paraqiteshit para autoritetit përgjegjës për hapjen e dosjeve për të kontrolluar nëse ka ndonjë material për ju apo për të afërmit tuaj? (përgjigjet e ish-të përndjekurve)



Informacionet e mësipërme tregojnë mungesë të interesit personal nga ana e popullatës së përgjithshme në lidhje me marrjen e informacioneve nga dosjet, por duket se të persekutuarit janë dukshëm më të interesuar dhe të prekur nga ligji. Sidoqoftë, një përqindje më e lartë e të anketuarve tregoi interes për t'u informuar rreth punës së autoritetit

përgjegjës për hapjen e dosjeve. Koncretisht, 40% e të anketuarve pohojnë se janë të interesuar të informohen rreth punës së autoritetit dhe ky interes është më i lartë tek burrat (45% dëshirojnë të informohen) krahasuar me gratë (vetëm 35% dëshirojnë të informohen).

A do të donit të informoheshit për punën e autoritetit përgjegjës për hapjen e dosjeve sekrete të komunizmit në Shqipëri? (sipas gjinisë)




Mbështetja për hapjen e dosjeve

Në përgjithësi, ligji për hapjen e dosjeve sekrete të ish-Sigurimit gëzon mbështetjen e pak më shumë se gjysmës së qytetarëve shqiptarë, ndërsa vetëm 5% e të anketuarve e kundërshtojnë atë. Sidoqoftë, një numër i madh qytetarësh (37%), thonë se nuk kanë informacion të mjaftueshëm për ligjin që të japin mendim. Një përqindje më e madhe e grave

pohon se nuk kanë informacion të mjaftueshëm për ligjin krahasuar me burrat. Në përgjithësi, burrat e mbështesnin më fort se sa gratë, ligjin për hapjen e dosjeve, ku 33% e burrave e mbështesnin fuqimisht krahasuar me vetëm 18% të grave.


Në çfarë mase e kundërshtoni apo e mbështesni ligjin për hapjen e dosjeve sekrete të ish-sigurimit?



Në bazë të përgjigjeve përgjatë rajoneve të ndryshme, ky ligj kundërshtohet pak dhe pothuajse në të njëjtin nivel në të gjithë vendin (rreth 5%). Sidoqoftë, në Veri ka një përqindje të madhe të të anketuarve që thonë se nuk kanë informacion të

mjaftueshëm rreth ligjit për të dhënë mendim. Përqindja më e lartë e të anketuarve që deklarojnë se “mbështesin fort” ligjin janë në rajonin Jug/Jug-perëndimor.

Në çfarë mase e kundërshtoni apo mbështesni ligjin për hapjen e dosjeve sekrete të ish-Sigurimit?




Gati 90% e personave që e kanë lexuar ligjin e mbështesin atë (e mbështesin shumë ose pak). Nuk kishte ndryshime

të mëdha të mbështetjes midis burrave dhe grave që kishin lexuar ligjin.



Në çfarë mase e kundërshtoni apo mbështesni ligjin për hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit? (sipas Gjinisë)



Pritshmëritë dhe shpresat në lidhje me hapjen e dosjeve

Në përgjithësi, qytetarët shprehin pozitivisht tek hapja e dosjeve, veçanërisht në lidhje me elementet e lustracionit potencial për zyrtarët publikë. Sidoqoftë, ata shprehin gjithashtu rezerva të forta rreth faktit se a do ketë hapja e dosjeve këtë efekt të dëshiruar.

Shumica e qytetarëve mendojnë se krijimi i një arkivi të konsoliduar me dokumente të ish- Sigurimit është i rëndësishëm për historinë e Shqipërisë dhe gati katër në pesë të anketuarve mendojnë se historia e vendit do të përfitonte nga krijimi i një arkivi të konsoliduar të ish-Sigurimit.

Qytetarët e kishin mjaft përzemër efektin potencial të lustracionit nga hapja e dosjeve. Gati 80% u përgjigjën

se zyrtarët publikë në detyrë, të cilët zbulohen se kanë qenë pjesëtarë të ish- sigurimit, duhet të japin dorëheqje nga detyra publike. Një përqindje e ngjashme e lartë e të anketuarve mendojnë se informacioni për lidhjet e mëparshme të zyrtarëve publikë me ish- Sigurimin duhet të publikohen (75%). Gjithashtu, shumica e të anketuarve (59%) nuk janë dakord me pohimin, 'Përfshirja e figurave publike me ish- sigurimin gjatë periudhës së komunizmit duhet parë si pjesë e së shkuarës dhe nuk duhet të ketë ndikim në karrierën e tyre'.

Rezultatet tregojnë gjithashtu se shumica e të anketuarve nuk e sheh hapjen e dosjeve si kërcënim për sigurinë kombëtare.

A pajtoheni me pohimet e mëposhtme ?

■ Pajtohem plotësisht
 ■ Pajtohem
 ■ Nuk Pajtohem aspak
 ■ Nuk Pajtohem
 ■ Nuk e di




Sidoqoftë, kishte mosbesim të fortë rreth procesit. Një numër domethënës i të anketuarve (64%) besojnë se shumica e dosjeve të ish- Sigurimit janë ndryshuar apo shkatërruar nga personat e interesuar, çka e bën të kotë hapjen e tyre. Gjithashtu, shumica e të anketuarve mendojnë se do të ketë persona apo institucione që do të përpiqen të pengojnë

veprimtarinë e autoritetit përgjegjës për hapjen e dosjeve. Rezultatet e anketës tregojnë se rreth 70% e të anketuarve mendojnë se një gjë e tillë ka gjasa të ndodhë, me një përqindje lehtësisht më të lartë të burrave që presin që të ndodhë një gjë e tillë.



A mendoni se do të ketë persona apo institucione që do të pengojnë veprimtarinë e autoritetit për dosjet?
(sipas gjinisë)



Për të shkuar më thellë në lidhje me pritshmëritë dhe dëshirat e publikut rreth hapjes së dosjeve, u hartuan dy skenarë. Për secilin skenar, të anketuarve iu kërkua të përshkruajnë

se çfarë dëshirojnë të ndodhë dhe çfarë mendojnë se do të ndodhë në të vërtetë, në bazë të fakteve në dispozicion dhe perceptimit të tyre rreth situatës në Shqipëri.

Skenari 1:

Autoriteti përgjegjës për hapjen e dosjeve zbulon se një zyrtar publik shumë i rëndësishëm, aktualisht në detyrë, ka


qenë pjesëtar i ish- Sigurimit.

Çfarë duhet të ndodhë:

38% e të anketuarve mendojnë se zyrtari publik duhet të japë dorëheqjen dhe e njëjta përqindje e të anketuarve mendojnë se institucioni ku punon ai/ajo duhet ta shkarkojë nëse personi nuk jep vetë dorëheqjen. Vetëm 16% e të anketuarve mendojnë se e shkuara komuniste e personit nuk ka rëndësi për rolin aktual të zyrtarit dhe nuk duhet të ndodhë asgjë.

Skenari 1:

Autoriteti përgjegjës për hapjen e dosjeve sekrete të ish- Sigurimit në Shqipëri zbulon se një zyrtar publik shumë i rëndësishëm ka qenë pjesë e shërbimit sekret.




- Zyrtari (ja) publik (e) duhet të japë dorëheqjen
- Institucioni ku ai/ajo punon duhet ta largojë atë edhe nëse zyrtari (ja) nuk jep dorëheqjen
- Nuk duhet të ndodhë asgjë. E shkuara e tij/saj komuniste nuk ka rëndësi për punën e tij aktuale
- Nuk e di

Çfarë do të ndodhte nëse media publikon një informacion të tillë:

Nëse informacioni bëhet publik nga media, gati gjysma (47%) e të anketuarve mendojnë se me shumë gjasa do të niste një proces hetimor, por që nuk do të arrinte asnjë përfundim. Vetëm 27% mendonin se zyrtari publik në fjalë do të shkarkohej nga pozicioni i tij/saj.

Skenari 1:

(Nëse informacioni bëhet publik nga media)



- Informacioni injorohet plotësisht nga autoritetet
- Hapet një hetim por ai nuk arrin asnjëherë në konkluzion
- zyrtari(ja) publik(e) shkarkohet nga posti që mban dhe i hiqet e drejta për të qenë pjesë e administratës publike në të ardhmen
- Nuk e di



Skenari 2:

Një zyrtar i lartë, i cili ka ndikim të madh, ndërhyr tek autoriteti përgjegjës për hapjen e dosjeve të ish- Sigurimit për të mos

lejuar hapjen e dosjes dhe publikimin e informacionit rreth tij/saj.

Çfarë do të ndodhte? :



Pjesa më e madhe e të anketuarve mendon se autoriteti do t'i rezistonte presionit; 35% mendon se rezultati më i mundshëm është që autoriteti të raportonte përpjekjen për ndërhyrje dhe se zyrtari do të ndiqej penalisht dhe 17% mendon se autoriteti do t'i rezistonte presionit dhe do të vazhdonte procedurat në lidhje me dosjen. Nga ana tjetër, 33% mendon se autoriteti do të dorëzohej para presionit,

Çfarë do të ndodhte nëse media publikon një informacion të tillë? :

si në rastin e skenarit 1, plot 47% mendon se rezultati më i mundshëm është që do të niste një proces hetimor, por që nuk do të arrinte asnjë përfundim.

Skenari 2: Një zyrtar i lartë me ndikim ndërhyr në punën e Autoritetit përgjegjës për hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit, duke synuar të mos lejojë hapjen dhe publikimin e dokumenteve rreth tij/saj

Skenari 2: (Nëse informacioni bëhet publik nga media)



- Autoriteti përgjegjës për hapjen e dosjeve tërhiqet përpara presionit të zyrtarit të lartë, duke mbajtur të fshehur
- Autoriteti përgjegjës i reziston trysnisë së zyrtarit dhe vijon punën për përpunimin e dosjeve rreth tij/saj
- Autoriteti përgjegjës denoncon ndërhyrjet e zyrtarit të lartë në punën e tij dhe zyrtari ndiqet penalisht
- Nuk e di

- Informacioni injorohet plotësisht nga autoritetet
- Hapet një hetim, por ai nuk arrin asnjëherë në përfundim
- Zyrtari publik shkarkohet nga posti që mban dhe i hiqet e drejta për të qenë pjesë e administratës publike në të ardhmen
- Nuk e di


2. Lustracioni

Shumica e të anketuarve besojnë se shumë politikanë aktualë kishin pozicione të rëndësishme gjatë regjimit të mëparshëm, dhe një shumicë e ngjashme e të anketuarve mbështet ekzistencën e një ligji për lustracionin. Rreth 73%

e të anketuarve mendojnë se një numër i madh politikanësh aktualë në Shqipëri kishin pozicione të rëndësishme gjatë periudhës komuniste dhe për këtë arsye atyre duhet t'iu ndalohet shërbimi në një post publik.

A pajtoheni me pohimin e mëposhtëm?


Një numër i konsiderueshëm politikanësh në Shqipëri sot, kanë mbajtur pozicione të rëndësishme gjatë periudhës komuniste prandaj nuk duhet lejuar të jenë deputetë, politikanë, apo zyrtarë të administratës publike.



80% e të anketuarve mbështesin hartimin dhe zbatimin e një ligji lustracioni në të ardhmen për të shkarkuar njerëzit

që ndodhen aktualisht në detyrë, të cilët kanë pasur role drejtuese në institucionet e regjimit komunist.

Në çfarë mase e mbështesni hartimin dhe zbatimin në të ardhmen të një ligji për largimin e zyrtarëve publikë, të cilët kanë qenë në pozicionet drejtuese përgjatë regjimit komunist?




3. Të mësuarit rreth së shkuarës

Shumica e të anketuarve, mbi 80% e të anketuarve, mendojnë se ka disa aspekte të periudhës komuniste që ia vlen t'i shpjegohen brezave të rinj. Sidoqoftë, në kundërshtim me këtë, 36% e të anketuarve ishin dakord se kjo pjesë e historisë nuk i duhet shpjeguar brezave të ardhshëm,

por duhet të harrohet plotësisht. 74% ishin dakord se kishte mësimet pozitive që mund të merreshin nga të rinjtë nga kjo periudhë e të shkuarës së Shqipërisë, si barazia, vullnetarizmi dhe komuniteti.

Në çfarë mase pajtoheni me pohimet e mëposhtme?




GJETJET KRYESORE


Në lidhje me interesin e tyre për të mësuar rreth të shkuarës komuniste, rezultatet e anketës tregojnë se nga 27% e të anketuarve (274 persona) që pohuan se ishin "kryesisht të

pa informuar" rreth periudhës komuniste, shumica e tyre nuk ishin të interesuar të mësonin më shumë rreth kësaj pjese të historisë së Shqipërisë.

Sa të informuar do të thoni se jeni për periudhën komuniste të Shqipërisë?



Sa të interesuar jeni për të mësuar më shumë rreth periudhës komuniste në Shqipëri?




Media luan rol të rëndësishëm në shoqëri dhe potencialisht mund të ketë ndikim në të mësuarin rreth të shkuarës. Rezultatet e anketës tregojnë se shumica e qytetarëve shqiptarë, (56%) vlerësojnë si përgjithësisht pozitiv rolin e medias për informimin e publikut të gjerë rreth periudhës së

komunizmit. Sidoqoftë, plot 38% mendojnë se kontributi i medias në këtë drejtim nuk është pozitiv. Rezultatet e anketës tregojnë se të anketuarit shohin “dokumentarë historikë” (69%) dhe “filma” (45%) si formatet më të përshtatshme për të ngjallur interesin e brezave të rinj rreth kësaj periudhe.



Cilat forma të medias mendoni se janë më të përshtatshme për të rritur interesin e brezave të rinj për të shkuarën komuniste në Shqipëri?




4. Falja

Shumica e shqiptarëve, 81% e të anketuarve, shprehen se janë "dakord" ose "shumë dakord" me idenë që t'iu kërkohet falje publike të gjithë shqiptarëve për padrejtësitë e regjimit komunist. Ama, duhet vënë re se 11% nuk janë dakord me

këtë ide. Anketa nuk përfshinte pyetje vijuese se kush duhet të kërkojë falje apo pse. 11% janë kundër.

Në çfarë mase jeni dakord me pohimin e mëposhtëm?

Shqiptarët meritojnë një shfaqësim zyrtar për persekutimin dhe padrejtësinë e vuajtur nën regjimin komunist përpara se të ecim përpara.




5. Vendet e kujtesës


Rezultatet e anketës tregojnë se rreth 90% e të anketuarve mbështesin ngritjen e një muzeu kombëtar për diktaturën komuniste. Gjithashtu, 63% e të anketuarve mendojnë se vendet e persekutimit (p.sh. burgjet dhe kampet e internimit) duhet të ruhen. Vihen re luhatje të ndjeshme kur të dhënat ndahen sipas rajoneve, por jo sipas gjinisë dhe arsimit. Dy

rajone jugore kanë një përqindje më të lartë që mendojnë se vendet e persekutimit duhet të ruhen (rreth 70%, krahasuar me 58% në Qendër dhe vetëm 54% në Veri). Veriu është rajoni me përqindjen më të madhe të të anketuarve që deklarojnë se nuk duhet bërë asgjë me këto vende.

Në çfarë mase e mbështesni ngritjen e një Muzeu Kombëtar për diktaturën komuniste?




Çfarë mendon se duhet bërë sot me vendet/zonat e persekutimit në Shqipëri?



Të pyetur rreth projektit të një kompanie private që synon të hapë përsëri minierën e një kampi të mëparshëm pune të detyruar, shumë të anketuar (58%) mendojnë se "kompanisë duhet t'i lejohet të gërmojë minierën, por me disa kufizime

për të ruajtur historinë e vendit". Ndërsa vetëm një në dhjetë të anketuar mendojnë se ruajtja e historisë së vendit është përparësi më e lartë dhe duhet të mënjanojë shfrytëzimin e burimeve.

Një ish kamp i punës së detyruar nga periudha komuniste ndodhet afër një burimi mjaft të çmuar të mineraleve. Një kompani private dëshiron ta rihapë minierën në një pjesë të këtij ish-kampi. Çfarë mendoni se duhet të ndodhë në një rast të tillë?



C. NJOHURI PËR TË SHKUARËN KOMUNISTE TË SHQIPËRISË

Qytetarët shqiptarë deklarojnë se, në përgjithësi, janë të informuar për të shkuarën komuniste. Personat që kishin më gjasa të deklaroheshin se ishin "disi të informuar" përfshijnë gratë, të rinjtë (16-35 vjeç) dhe të anketuarit nga veriu. Sidoqoftë, duke qenë se vetë-deklarimi ofron vlerësim të kufizuar njohurish, anketa i drejtoi të anketuarve pyetje rreth fakteve të jetës gjatë komunizmit, figurave publike dhe politike, të persekutuarve, datave dhe ngjarjeve të rëndësishme. Anketa përfshinte gjithashtu skenarë për të vlerësuar njohuritë rreth çështjeve më të ndërlikuara, përtej emrave dhe datave. Kishte pritshmëri që më të vjetrit në moshë do të kishin më


shumë njohuri rreth regjimit dhe jetës gjatë tij, dhe një gjë e tillë u pohua dhe nga të dhënat. Shumica e personave që deklaruan se ishin "shumë të informuar" përmendën përvojat personale si burimin kryesor të informacionit dhe kuptohet që grupmoshat më të reja nuk kanë shumë, në mos fare, përvoja personale me komunizmin. Ka raste mungese të habitshme njohurish dhe jo thjesht në varësi të grupmoshës. Për shembull, njohuritë rreth Sabiha Kasimatit, një grua intelektuale e ekzekutuar nga regjimi, ishin mjaft të ulëta në krahasim me njohuritë rreth shumë burrave intelektualë të ekzekutuar nga regjimi.

1. Vlerësim vetjak i nivelit të përgjithshëm të njohurive


Të pyetur se sa të informuar janë për periudhën komuniste në Shqipëri, shumica e të anketuarve ndihen të informuar, qoftë

shumë të informuar (38%) ose disi të informuar (35%).

Sa të informuar do të thoni se jeni për periudhën komuniste të Shqipërisë?



Sa të interesuar jeni për të mësuar më shumë për periudhën komuniste të Shqipërisë?




Ndërmjet të anketuarve që ndjeheshin "disi të painformuar", rezultatet e anketës tregojnë një përqindje të lehtë më të lartë të grave në krahasim me burrat. Kishte ndryshim shumë të madhe ndërmjet grupmoshave dhe shumica e të anketuarve


që deklaruan se ishin "disi të painformuar" i përkasin të moshave 16-35 vjeç. Nga pikëpamja gjeografike, të anketuarit të cilët deklaruan se ishin të painformuar kishin tendencën të ishin nga zonat veriore dhe qendrore.

Sa të informuar do të thoni se jeni për periudhën komuniste të Shqipërisë


Qytetarët që janë më së shumti të painformuar sipas gjinisë.



Qytetarët që janë më së shumti të painformuar sipas moshës.




Qytetarët që janë shumë të informuar sipas rajonit.



Për të anketuarit që ndiheshin "shumë të informuar", rezultatet e anketës tregojnë se ky grup përfshinte pak më shumë burra se gra, shumicën e personave me moshë më të madhe se

55 vjeç dhe një përqindje disi më të madhe të rezidentëve në rajonin jug/jug-lindor.

Sa të informuar do të thoni se jeni për periudhën komuniste të Shqipërisë (personat të cilët janë shumë të informuar)?



Për pyetjen se cili është burimi kryesor i informacionit për periudhën komuniste, shumica e të anketuarve (mbi 80%) që u përgjigjën se ishin "shumë të informuar" përmendën përvojat personale si burim informacioni. Televizioni është burimi i dytë më i rëndësishëm për personat "shumë të informuar" dhe

burimi më i rëndësishëm për dy grupet e tjera, gjë që nënvizon rolin parësor të tij në informimin e shqiptarëve mbi të kaluarën komuniste. Është interesant fakti se sa pak peshë ka shkolla në informimin e njerëzve për epokën komuniste.


Nga cilat burime e merrni informacionin për të shkuarën komuniste të Shqipërisë? (bazuar në nivelin e informacionit)



Kur të dhënat ndahen sipas arsimit, është e qartë se shkolla është burimi më i rëndësishëm i informacionit për personat më të arsimuar, por rëndësia e saj krahasuar me burimet e tjera është ende tepër e ulët. Vetëm 17% e të diplomuarve në universitet rëndisin shkollën si burim informacioni për kohën komuniste. Rezultatet tregojnë se sa më shumë vite shkollim,

aq më shumë probabilitet ka që personat të konsiderojnë shkollën si një nga burimet e informacionit për këtë pjesë të së shkuarës.

Nga cilat burime e merrni informacionin për të shkuarën komuniste të Shqipërisë?




2. Njohuri për disa veçori të jetës gjatë Komunizmit

Të anketuarve iu dhanë nëntë pohime rreth disa prej veçorive të jetës gjatë periudhës Komuniste në Shqipëri, në lidhje me lëvizjen e lirë, blerjen e mallrave, shëndetësinë, punësimin, shërbimin ushtarak, etj. Katër nga pohimet ishin të vërteta ndërsa pesë ishin të pavërteta. Rezultatet e anketës treguan se rreth 95% e të anketuarve dhanë të paktën pesë përgjigje të sakta, duke treguar se në përgjithësi shqiptarët kanë nivel të mirë njohurish për karakteristikat e jetës gjatë regjimit Komunist. Sidoqoftë, disa nga pyetjet që morën përgjigje të gabuara tregojnë se ka dhe boshllëqe. Mbi 90% e të anketuarve pohuan në mënyrë të saktë se “shteti garantonte punësim për të gjithë” gjatë periudhës Komuniste në Shqipëri, dhe e njëjta përqindje pohoi gjithashtu në mënyrë të saktë se shëndetësia


pa pagesë ishte një nga veçoritë e tjera të periudhës Komuniste. Sidoqoftë, 36% e të anketuarve mendojnë gabimisht se shqiptarët mund të udhëtonin lirish brenda vendit edhe pse shumica e të anketuarve e dinin se kishte kufizime të udhëtimit brenda shtetit. Gati të gjithë të anketuarit, (95%) e dinin se shqiptarët nuk mund të udhëtonin lirish jashtë shtetit. Sidoqoftë, vetëm 65% e të anketuarve pohuan në mënyrë të saktë se arsimit universitar nuk ishte i mundur për të gjithë. Gjithashtu, 76% pohuan në mënyrë të saktë që, gjatë periudhës Komuniste, qytetarët nuk mund të ndërronin lirish vendbanimin nga një qytet apo fshat në një tjetër.

Percaktoni nëse pohimet e mëposhtme janë të vërteta apo të gabuara.

*Pohime të sakta



*Pohime të gabuara



GJETJET KRYESORE


Për të zbuluar më në thellësi njohuritë rreth karakteristikave të jetës gjatë periudhës komuniste, të anketuarve iu dhanë disa skenarë që përshkruanin situata të hamendësuara. Atyre

iu kërkua të jepnin mendim se si do shkonin gjërat, duke u bazuar tek faktet e përmendura në skenar.

Skenari 1:

Një qytetar i klasës punëtore gjatë periudhës komuniste në Shqipëri dëshiron të blejë një televizor të ri. Çfarë duhet të bëjë ai/ajo për të blerë televizorin?

Një qytetar i zakonshëm në Shqipërinë komuniste dëshiron të blejë një TV të ri. Për të bërë këtë, atij / asaj.



Rezultatet nga Skenari 1 tregojnë që shumica e të anketuarve (86%) ishin të ndërgjegjshëm se nevojitej autorizim për të blerë televizor të ri. Më shumë se gjysma e të anketuarve (59%) u përgjigjën saktë, duke nënvizuar se personit do t'i nevojitej leje nga autoriteti në vendin e tyre të punës. Sidoqoftë, 27% u përgjigjën se personit do t'i nevojitej leje nga Partia e Punës, çka është e pasaktë. Një përqindje më e vogël e personave, nga grupmosha 16-35 vjeç, iu përgjigj


saktë kësaj pyetjeje (vetëm 50% u përgjigjën saktë në krahasim me 64% të personave më të vjetër). Sidoqoftë, një numër jo i vogël i të anketuarve me moshë më të vjetër u përgjigjën në mënyrë të pasaktë (36% e të anketuarve mbi 55 vjeç). Gjithashtu, kishte një luhatje të lehtë në lidhje me rajonet, ku vetëm 49% e të anketuarve nga Rajoni Verior zgjedhën përgjigjen e saktë, ndërsa kjo përqindje ishte më e lartë se 60% për të anketuarit nga rajonet e tjera.

Skenari 2:

Një familje e zakonshme e Shqipërisë komuniste në vitet '80 dëshiron të blejë ushqim në dyqan. Duke marrë për të

mirëqenë se familja zotëron fondet e nevojshme për të blerë sa ushqim i nevojitet, si duhet të veprojë kjo familje?

Një familje tipike në Shqipërinë komuniste gjatë viteve 80, planifikon të blejë sasinë e nevojshme të ushqimeve në treg. Supozojmë se kjo familje i ka mundësitë financiare për të blerë të gjithë sasinë e ushqimeve që i nevojitet për konsum, bazuar në numrin e anëtarëve. Në një rast të tillë, kjo familje:



Rezultatet e anketës për Skenarin 2 tregojnë që koncepti i tollonit njihet gjerësisht nga të anketuarit, por shumë prej tyre nuk dinin nëse sasia e ushqimit ishte me racione. Specifikisht, pak më shumë se gjysma (57%) e të anketuarve u përgjigjën në mënyrë të sakë që një familje në situatën e treguar nga skenari kishte nevojë të merrte autorizim, çka do të kufizonte sasinë e ushqimit që familja mund të blinte. Çereku i të anketuarve tha që familja do të kishte nevojë për autorizim, por mendonin gabimisht se nuk kishte kufizim të


sasisë së ushqimit që mund të blihej. 14% e të anketuarve, të moshave 16-35 vjeç, nuk mund të jepnin përgjigje për këtë skenar, në krahasim me vetëm 3% të të anketuarve mbi 55 vjeç që thanë se nuk e dinin. Kishte një luhatje të lehtë ndërmjet rajoneve në lidhje me përgjigjet, ku vetëm 49% e të anketuarve nga rajoni jug/jug-perëndim (Berat, Fier, Vlorë, dhe Gjirokastrë) u përgjigjën saktë, ndërsa rajonet e tjera kishin përqindje më të lartë përgjigjesh të sakta (rreth 60%).

Skenari 3:

Në një familje të zakonshme prej katër anëtarësh në periudhën komuniste në Shqipëri, fëmija i vogël sapo ka mbaruar shkollën e mesme, ndërsa fëmija më i madh vazhdon studi-

met në universitet. Në rast se i më vogli i fëmijëve dëshiron të vazhdojë studimet dhe të regjistrohet në universitet, çfarë ka më shumë mundësi të ndodhë?

Në një familje tipike në Shqipëri në komuniste, prej 4 personash, fëmija i vogël sapo ka përfunduar shkollën e mesme, ndërsa fëmija i madh vazhdon studimet e larta. Në rastin kur më i vogli i fëmijëve dëshiron të regjistrohet në universitet, çfarë ka më shumë gjasa të ndodhë?



Për Skenarin 3, rezultatet e anketës tregojnë se shumica e të anketuarve (80%) janë të ndërgjegjshëm për kufizimet rreth vazhimit të arsimit të lartë. Kjo shifër është dhe më e lartë në rajonin jug/jug-perëndim, ku 91% e të anketuarve i njihnin këto kufizime. Ky Skenar kishte dy përgjigje që mund të konsiderohen si të sakta, por njëra nga ato ishte më e saktë në kuadrin që kishte më shumë gjasa të ndodhte. 56% e të anketuarve zgjedhën alternativën më të saktë, duke pohuar se në përgjithësi vetëm një nga fëmijët e shtëpisë mund të shkonte në universitet. Alternativa sipas të cilës familja


mund të aplikonte për autorizim që fëmija i dytë të shkonte në universitet u zgjodh nga 24% e të anketuarve, duke treguar se e njihnin ekzistencën e kufizimit, por që nuk e dinin se një gjë e tillë ishte rezultati më me gjasa. Gjithashtu, 10% e të anketuarve nuk ishin të aftë të përgjigjeshin dhe e njëjta përqindje nuk i njihje kufizimet rreth vazhimit të arsimit të lartë. Dhe në këtë rast, vërejmë se grupmosha 16-35 vjeç ka përqindje më të ulët të përgjigjeve të sakta në krahasim me grupet më të vjetra në moshë. Nga pikëpamja e rajoneve, ka luhataje të lehtë ku banorët në rajonin jug/jug-perëndim kishin përqindje më të lartë të përgjigjeve të sakta.

3. Njohuri për disa aspekte të jetës politike gjatë komunizmit

Të pyetur rreth numrit të anëtarëve të Partisë së Punës në vitin 1990, në fund të regjimit, rezultatet e anketës tregojnë se shumica e të anketuarve (mbi 90%) ose nuk e dinë ose dhanë përgjigje të gabuar. Vetëm 8% e të anketuarve dhanë përgjigje të saktë (100,000-200,000 anëtarë) dhe, ndërsa 26%

e të anketuarve mbivlerësoi anëtarësinë e Partisë së Punës, shumica thjesht nuk e dinte (54%). Nuk kishte ndryshime thelbësore ndërmjet grupmoshave edhe pse 13% e atyre më të vjetër se 55 vjeç u përgjigjën në mënyrë të saktë, krahasuar me vetëm 5% të atyre të moshave 16-35 vjeç.


Sipas informacionit tuaj, sa anëtarë kishte Partia e Punës gjatë periudhës komuniste në Shqipëri?



Për të zbuluar njohuritë rreth figurave politike kyçe, të anketuarve iu dha një listë me gjashtë figura publike nga periudha komuniste në Shqipëri dhe u pyetën se sa informacion kanë për secilin. Të dhënat tregojnë se në përgjithësi Ramiz Alia ishte personi më i njohur nga lista, dhe

46% të të anketuarve pohojnë se “dinë shumë” (16%) ose “kanë njohuri mesatare” (30%) rreth Ramiz Alisë. Nga ana tjetër, Liri Belishova ishte personi i njohur më pak, me vetëm 24% të të anketuarve që deklarojnë se kanë “shumë njohuri” apo “njohuri mesatare” rreth saj.


Sa informacion keni për secilën nga figurat publike të periudhës?



Në përgjithësi, të anketuarit me moshë më të madhe se 55 vjeç deklarojnë se janë më të informuar rreth këtyre figurave

publike. Nga ana tjetër, 16-35 vjeçarët deklarojnë se kanë më pak informacion rreth këtyre figurave publike.

Sa informacion keni për secilën nga figurat publike të periudhës?




Të anketuarve iu kërkua, gjithashtu, të përmendnin emrat e tre anëtarëve të Byrosë Politike së Partisë së Punës, që kishin qenë ende aktivë gjatë ndryshimit të sistemeve, pra në vitin 1990. Të dhënat e anketës tregojnë se emri më i përmendur ishte ai i Ramiz Alisë nga pak më shumë sesa gjysma (53%)


e të anketuarve. Grupmosha më e re është më pak në gjendje nga të gjithë të identifikojë anëtarë të Byrosë Politike. Megjithatë, nuk kishte ndonjë ndryshim të madh midis grupmoshave dhe njohja e këtyre figurave politike duket në përgjithësi shumë e pakët, me përjashtim të Ramiz Alisë.

GJETJET KRYESORE


A mund të përmendni 3 anëtarë të byrosë politike në Shqipëri të cilët ishin ende në aktiv, pas ndryshimeve të vitit 1990, në Shqipëri?



Në tre emra të përdorur sa emra të saktë janë thënë?



Përveç emrit të Ramiz Alisë, në tre emra të përmendur sa emra të saktë janë thënë?




- Asnjë e saktë
- Vetëm 1 emër i saktë
- Vetëm 2 emra të saktë
- Te tre emrat e saktë
- Asnjë e saktë
- 1 emër i saktë nga 3 gjithsej
- 1 emër i saktë nga 2 gjithsej
- 2 emra të saktë nga 3 gjithsej
- Të gjithë emrat e saktë

Të anketuarit u pyetën edhe nëse Shqipëria ka qenë ndonjëherë anëtare e Traktatit të Varshavës. Rezultatet tregojnë se pothuajse 30% e të anketuarve nuk e dinin përgjigjen. Megjithatë, shumica e të anketuarve (58%) dhanë një përgjigje të saktë, duke deklaruar se Shqipëria kishte

qenë anëtare e Traktatit të Varshavës për një periudhë të caktuar kohe në historinë e saj. Brezi më i ri duket më pak i informuar sesa grupmoshat e tjera. Vetëm 51% e tyre iu përgjigjën saktë kësaj pyetjeje.


Sipas njohurive tuaja, a ka qenë Shqipëria ndonjëherë pjesë e Paktit/Traktatit të Varshavës?



Shumica e të anketuarve (79% e numrit total) u përgjigjën me saktësi rreth vitit të vdekjes së Enver Hoxhës, i cili ishte viti 1985. Megjithatë, mes të anketuarve të moshës 16-35 vjeç,

vetëm 62% ishin në gjendje ta identifikonin këtë datë, ndërsa një përqindje mjaft e lartë (21%) thanë se thjesht nuk e dinin.

Në cilin vit ka vdekur Enver Hoxha?



4. Informimi rreth të persektuarve

Të anketuarve iu dha një listë prej shtatë personash dhe u pyetën se cilët prej tyre ishte persektuar nga regjimi. Dy prej personave të renditur nuk kishin qenë të persektuar, kurse të tjerët po. Në përgjithësi, informimi rreth të persektuarve duket i ulët dhe për pjesën më të madhe të personave të renditur në listë, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve thjesht nuk dinin asgjë.

Një pjesë e madhe e të anketuarve (73%) ishin në gjendje ta identifikonin saktësisht Pjetër Arbnorin si një person i ish-

persektuar. Gjithashtu, pjesa më e madhe e të anketuarve (54%) kanë dijeni se At Zef Pllumi ka qenë i persektuar. Megjithatë, njohja e figurave të tjera të persektuar është e pakët dhe vetëm 19% e të anketuarve e dinin se Sabihe Kasimati, e vetmja grua në listë, ishte persektuar. Afërsisht gjysma e të gjithë të anketuarve u përgjigjën saktë se Pali Miska dhe Manush Myftiu nuk ishin persektuar. Megjithatë, gjysma tjetër nuk e dinin këtë ose ishin të keq informuar.

A ishin personat e mëposhtëm të persektuar nga regjimi komunist?



* Nuk janë persektuar nga regjimi komunist

■ Po ■ Jo ■ Nuk e di


D. PERCEPTIMET RRETH REGJIMIT KOMUNIST TË SHQIPËRISË

1. Perceptimet rreth komunizmit shqiptar

Shqiptarët duken të ndarë në perceptimin e përgjithshëm për periudhën e komunizmit, por përgjigjja më e zakonshme është se komunizmi në vend ka qenë "ide e mirë, por e zbatuar keq". Pothuajse gjysma e të anketuarve mendojnë se komunizmi në Shqipëri ka qenë "ide e mirë, por e zbatuar keq" dhe nuk ka ndonjë ndryshim mes grupmohave në këtë opinion. 37% mendojnë se komunizmi ishte thjesht një "ide e keqe", sërish me shumë pak ndryshime mes grupmohave. Vetëm 10% pohuan se komunizmi ka qenë "ide e mirë, e zbatuar siç duhet", por ka ndryshim mes grupmohës mbi 55 vjeç, që janë sa dyfishi (13%) i personave të grupmohës 16-35 vjeç (7%) që ndajnë të njëjtin mendim.

Sipas rajoneve, rezultatet tregojnë se në rajonin qendror (Tiranë dhe Durrës), pjesa e të anketuarve që mendojnë se komunizmi në Shqipëri ishte thjesht "një ide e keqe" është pothuajse e barabartë me pjesën që mendon se ishte "ide e mirë, por e zbatuar keq". Megjithatë, në rajonet e tjera, pjesa e atyre që deklarojnë se komunizmi ka qenë 'ide e keqe' është më e vogël, kurse përgjigja më e shpeshtë është se komunizmi kishte qenë 'ide e mirë, por e zbatuar keq'. Përqindja më e lartë e njerëzve që deklarojnë se komunizmi në Shqipëri ishte 'ide e mirë, e zbatua keq' u evidentua në jug.

Sipas mendimit tuaj, komunizmi në Shqipëri: (sipas rajonit)




Gjithashtu, të anketuarve iu kërkua të shpreheshin nëse ishin dakord me disa vlerësime që krahasojnë jetën në komunizëm me jetën sot. Në përgjithësi, të anketuarve iu duket se në komunizëm, vendi ishte më i sigurt, arsimit më i mirë, kishte më shumë vende pune, më shumë siguri në punë, më shumë stabilitet politik, më pak korrupsion dhe më shumë barazi sa u përket standardeve të jetesës. Të anketuarit u

ndanë pothuajse përgjysmë kur u pyetën nëse jeta kishte qenë më e rehatshme në komunizëm (49%) apo nëse kishte qenë më pak e rehatshme në atë periudhë (48%). Shumica e të anketuarve mendojnë se zhvillimi ekonomik ishte më i dobët në komunizëm dhe se periudha e komunizmit ishte përgjithësisht më e keqe sesa e sotshme dhe se liria e shprehjes ishte më e vogël në komunizëm.



Shqipëria në kohën e komunizmit krahasuar me ditët e sotme:




GJETJET KRYESORE

Përveçse të shpreheshin nëse ishin dakord me listën e vlerësimeve të dhëna që krahasonin periudhën e komunizmit me kushtet e sotshme, të anketuarve iu kërkua gjithashtu të përmendnin tre aspekte pozitive dhe tre aspekte negative të periudhës së komunizmit në Shqipëri, sipas mendimit të tyre. Rendi publik, siguria e punës dhe kujdesi i mirë shëndetësor ishin tre aspektet më pozitive të periudhës së komunizmit sipas të anketuarve. Si aspektet më negative të kësaj periudhe të anketuarit identifikojnë mungesën e lirisë, luftën e klasave dhe shkeljen e të drejtave të njeriut.

Rendi publik është përmendur më shpesh si aspekt pozitiv i periudhës komuniste, pas të cilit renditet siguria në punë në vend të dytë dhe kujdesi i mirë shëndetësor në vendin e tretë. Të anketuarit mbi 55 vjeç janë përqendruar ndjeshëm tek rendi publik si aspekti më pozitiv, kurse për të rinjtë e moshës 16-35 vjeç, rendi publik dhe siguria në punë konsiderohen si aspekte pozitive të komunizmit me pothuajse të njëjtën rëndësi. Për të anketuarit mbi 55 vjeç, arsimi shihet po aq pozitivisht sa edhe kujdesi shëndetësor, kurse të rinjtë e përmendin arsimin më rrallë si aspekt pozitiv të komunizmit.


A mund të më thoni 3 aspektet më pozitive të periudhës komuniste në Shqipëri sipas jush? (sipas moshës)



Sa u përket aspekteve negative, mungesa e lirisë u përmend by far si pjesa më negative e komunizmit në Shqipëri, kurse lufta e klasave e dyta dhe shkelja e të drejtave të njeriut e treta. Edhe varfëria u përmend si aspekt negativ nga shumë të anketuar. Megjithatë, u vunë re dallime të dukshme mes grupmohave. Ndërsa mungesa e lirisë ishte aspekti negativ

më i përmendur nga të gjitha grupmohat, lufta e klasave u përmend nga 22% e të anketuarve mbi 55 vjeç, por vetëm nga 15% e grupmohës 36-55 dhe nga 5% e grupmohës 16-35. Pothuajse dyfishi (16-35 vjeç) mendojnë se shkelja e të drejtave të njeriut ishte aspekt negativ, krahasuar me të anketuarit mbi 55 vjeç.

A mund të më thoni tre aspektet më negative të periudhës komuniste në Shqipëri? (sipas moshës)




2. Standardi i jetesës

Të anketuarve iu kërkua të vlerësojnë kushtet e jetesës gjatë periudhës komuniste krahasuar me kushtet aktuale, ku intervistuesi nuk jep përkufizim për “kushtet e jetesës”. Rezultatet tregojnë se 77% e të anketuarve deklarojnë se kushtet e jetesës në Shqipërinë komuniste ishin më të këqija sesa sot dhe vetëm 13% thanë se kushtet e jetesës ishin më të mira sesa sot. Rezultatet nuk kishin dallime thelbësore për sa i përket grupmoshave, gjinisë apo rajonit. Rezultatet

tregojnë se të anketuarit e rajonit jugor kanë përqindjen më të lartë të personave që mendojnë se gjatë komunizmit jetohej më keq sesa sot, gjë që është interesante, sepse po ky rajon ka përqindjen më të lartë të të anketuarve që mendojnë se komunizmi ishte ide e mirë e zbatuar siç duhet. Rajoni qendror ka përqindjen më të lartë të të anketuarve që pohojnë se kushtet ishin më të mira. Gjithsesi, dallimet janë të vogla.


Sipas mendimit tuaj, kushtet e jetesës gjatë periudhës komuniste në Shqipëri ishin:



Të anketuarit u pyetën për të ardhurat e tyre familjare krahasuar me standardet e asaj kohe. Në përgjithësi, qytetarët shqiptarë pretendojnë se të ardhurat e tyre familjare gjatë periudhës komuniste ishin ose të ulëta ose mesatare krahasuar me standardet e kohës. Megjithatë, të anketuarit

me nivele më të larta arsimimi raportojnë përgjithësisht se të ardhurat e tyre gjatë komunizmit ishin ose "të larta" ose "shumë të larta". Kështu, 31% e të anketuarve me arsim të lartë u përgjigjën se të ardhurat e tyre kishin qenë ose të larta ose shumë të larta, dhe vetëm 8% e të anketuarve me arsim fillor dhanë të njëjtën përgjigje.

Si do ti cilësonit të ardhurat e familjes suaj gjatë periudhës komuniste në Shqipëri, krahasuar me standardet ekonomike të kohës?




3. Barazia gjinore

Shumica e qytetarëve mendojnë se gratë në shoqërinë shqiptare gjatë periudhës komuniste kishin rol më të dobët krahasuar me rolin që ato kanë sot. Megjithatë, qytetarët shqiptarë ndahen kur pyeten nëse burrat dhe gratë kishin të drejta të barabarta në periudhën komuniste në arsim, punësim dhe fusha të tjera.


Sipas të dhënave të anketës, kur u pyetën rreth rolit të grave në shoqërinë shqiptare në periudhën komuniste, rreth gjysma e të anketuarve (53%) mendojnë se gratë kishin rol më të dobët sesa sot. Nuk ka ndonjë dallim thelbësor në

perceptim midis grave dhe burrave, por të anketuarat gra e shihnin rolin e grave në komunizëm më të dobët krahasuar me burrat. Sipas rajoneve, rezultatet tregojnë se 34% e të anketuarve nga rajoni verior mendojnë se gratë kishin një rol më të fortë sesa sot, kurse në rajonin juglindor vetëm 17% e të anketuarve kanë të njëjtin mendim, duke shënuar një dallim të madh. Sipas grupmoshave, të anketuarit mbi 55 vjeç raportojnë se roli i grave ishte më i fortë në komunizëm (37%) krahasuar me brezat më të rinj, ku vetëm rreth 20% u përgjigjën se roli i grave kishte qenë më i fortë.


Sipas mendimit tuaj, krahasuar me ditët e sotshme, gratë në shoqërinë Shqiptare gjatë periudhës komuniste të vendit kishin një rol: (sipas gjinisë)



Sipas mendimit tuaj, krahasuar me ditët e sotshme, gratë në shoqërinë Shqiptare gjatë periudhës komuniste të vendit kishin një rol: (sipas rajonit)




Sipas mendimit tuaj, krahasuar me ditët e sotshme, gratë në shoqërinë shqiptare gjatë periudhës komuniste të vendit kishin një rol: (sipas moshës)




Kur u pyetën nëse burrat dhe gratë kishin të drejta të barabarta (p.sh.në arsim dhe punësim), të anketuarit ndahen në qëndrime: afërsisht gjysma deklarojnë " po " kurse gjysma deklarojnë " jo ". Të anketuarit më të mëdhenj në moshë kanë më shumë të ngjarë të pohojnë se gratë dhe burrat në periudhën komuniste kishin të drejta të barabarta (58% e atyre mbi 55 vjeç mendojnë kështu), sesa grupmoshat më

të reja (vetëm 44% e grup moshës 16-35 vjeç). Dukshëm, rajoni qendror ka një përqindje shumë më të ulët njerëzish që deklarojnë se burrat dhe gratë në komunizëm kishin të drejta të barabarta (vetëm 43% e të anketuarve). Krahasuar me të, juglindja ka përqindjen më të lartë të njerëzve që mendojnë se gratë kishin të drejta të barabarta me burrat, ku 60% e të anketuarve nga ky rajon pohojnë se kjo ishte e vërtetë.

Bazuar në njohuritë tuaja, gjatë periudhës komuniste në Shqipëri, a kishin burrat dhe gratë të drejta të barabarta në arsim, punësim etj.? (sipas moshës)



Bazuar në njohuritë tuaja, gjatë periudhës komuniste në Shqipëri, a kishin burrat dhe gratë të drejta të barabarta në arsim, punësim etj.? (sipas rajonit)



4. Perceptimet për disa figura publike nga epoka komuniste

Të intervistuarve iu kërkua të vlerësonin kontributin e disa figurave publike të periudhës komuniste në Shqipëri, pa u dhënë përkufizime sa i përket natyrës së kontributit. Të anketuarve iu kërkua të jepnin një vlerësim për ndikimin e Enver Hoxhës, Nexhmije Hoxhës dhe Ramiz Alisë në historinë e Shqipërisë.


Rezultatet e anketës tregojnë se të anketuarit ndahen sa i përket vlerësimit të kontributit të Enver Hoxhës. Rreth 45% e të anketuarve mendojnë se Enver Hoxha ka pasur ndikim negativ, kurse 42% mendojnë se ky ndikim ka qenë pozitiv. Sa i përket moshës së të anketuarve, grupmosha 16-35 vjeç duket të ketë një këndvështrim shumë më negativ për

kontributin e Enver Hoxhës sesa grupmoshat e tjera. Edhe të anketuarit me arsim të lartë kanë një qendrim dukshëm më negativ për Enver Hoxhën.


Përveç kësaj, rezultatet e anketës tregojnë se të anketuarit nga rajoni qendror kanë një perspektivë shumë më negative për kontributin e Enver Hoxhës (vetëm 33% u përgjigjën se ai kishte pasur ndikim pozitiv), megjithëse ky rajon ka edhe numrin më të madh të atyre që nuk iu përgjigjën fare kësaj pyetjeje. Të anketuarit nga rajoni jugor/jugperëndimor kanë vlerësimin më pozitiv për Enver Hoxhën, pasi më shumë se gjysma e të anketuarve (55%) në atë rajon deklarojnë se ai ka pasur ndikim pozitiv në historinë e vendit.

Cili është mendimi juaj për rolin e Enver Hoxhës në historinë e vendit?


Sipas moshës



Sipas edukimit



Cili është mendimi juaj për rolin e Enver Hoxhës në historinë e vendit? (sipas rajonit)




Kur iu kërkua të jepnin një vlerësim për ndikimin e Nexhmije Hoxhës, të anketuarit kishin mendime të ndryshme. Pjesa më e madhe e vlerësojnë ndikimin e saj si negativ (39%). Megjithatë, 21% e të anketuarve mendojnë se ajo ka pasur ndikim pozitiv dhe e njëjta përqindje mendojnë se ajo nuk ka pasur asnjë lloj ndikimi në historinë e Shqipërisë. Njerëzit më të arsimuar kanë tendencën për ta vlerësuar më negativisht ndikimin e saj. Megjithatë, pjesa e të anketuarve që nuk iu përgjigjën fare pyetjes rreth Nexhmije Hoxhës ishte ndjeshëm më e madhe sesa ajo që nuk iu përgjigj pyetjes për Enver

Hoxhën. Afërsisht 20% e të anketuarve deklaruan thjesht se nuk e kanë idenë, kurse përqindja e të rinjve (16-35 vjec) që deklaruan se nuk ia kanë idenë është dy herë më e lartë sesa përqindja e të anketuarve më të mëdhenj në moshë që dhanë të njëjtën përgjigje. Për këtë arsye, rezulton se një pjesë e mirë e njerëzve, sidomos të rinjtë, nuk kanë ndonjë mendim për Nexhmije Hoxhën. Nga të gjitha rajonet, të anketuarit nga rajoni jugor/jugperëndimor dhanë vlerësimin më pozitiv për ndikimin e Nexhmije Hoxhës.




Cili është mendimi juaj për rolin e Nexhmije Hoxhës në historinë e vendit?

Sipas moshës



Sipas arsimimit




Sa i përket Ramiz Alisë, numri i të anketuarve që u përgjigjën se ai kishte pasur ndikim pozitiv është më i lartë sesa i atyre që u përgjigjën se ai kishte pasur ndikim negativ (përkatesisht 41% dhe 35%). Rreth 26% e brezit më të ri nuk iu përgjigj fare pyetjes në lidhje me Ramiz Alinë, krahasuar me vetëm 10% të të anketuarve më të mëdhenj në moshë. Sa më të arsimuar janë të anketuarit, aq më negativisht e vlerësojnë ndikimin e Alisë – e njëjta tendencë që vihet re edhe për Enver Hoxhën dhe Nexhmije Hoxhën. Ka një


dallim të ndjeshëm nga një rajon në tjetrin, pasi Ramiz Alia shihet se ka pasur ndikim pozitiv në historinë e Shqipërisë nga rreth 50% e të anketuarve në të gjitha rajonet, përveç rajonit qendror ku vetëm 24% e të anketuarve e vlerësojnë kontributin e tij si pozitiv. Në të njëjtën kohë, rajoni qendror ka edhe pjesën më të madhe të personave që deklarojnë se nuk e kanë idenë – 24%, shifër që është pothuajse dy herë më e lartë sesa në rajonet e tjera.

GJETJET KRYESORE

Cili është mendimi juaj për rolin e Ramiz Alisë në historinë e vendit? (Sipas moshës)



Cili është mendimi juaj për rolin e Ramiz Alisë në historinë e vendit? (Sipas rajonit)






Të dhënat janë paraqitur të pa analizuar në mënyrë që palët e interesuara të vlerësojnë shifrat dhe të marrin parasysh vetë se çfarë nënkuptojnë këto të dhëna sipas fushës së tyre të ekspertizës. Sidoqoftë, më poshtë jepen disa përfundime me interes të veçantë për Prezencën, në një renditje rastësore.

- Në përgjithësi, qytetarët nuk e shohin trashëgiminë e të shkuarës komuniste si një problem të madh me të cilin përballet vendi sot, sidomos krahasuar me problematika të tjera më të mëdha si ekonomia, korrupsioni, keqqeverisja, pandëshkueshmëria dhe shëndetësia. Krahasuar me popullsinë në tërësi, ka më shumë gjasa që të persekutoarit ta shohin trashëgiminë komuniste si problem thelbësor. Në të njëjtën kohë, mbi një e treta e të persekutoarve janë të mendimit që kjo trashëgimi nuk është fare problem, çka e cila thekson faktin që perceptimi i tyre nuk është një i vetëm.
- Në përgjithësi, qytetarët e mbështesin hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit edhe pse një numër i konsiderueshëm njerëzish nuk e kanë informacionin e nevojshëm për ligjin që të mund të japin mendime. Duket se mbështetja për hapjen e dosjeve lidhet të paktën pjesërisht me potencialin e këtij procesi si mekanizëm lustracioni. Në të vërtetë, rezultatet e anketës tregojnë se ka shumë interes për lustracionin. Duke qenë se ligji për hapjen e dosjeve nuk parashikon lustracionin, ai mund të mos përmbushë shpresat apo pritshmëritë e publikut edhe nëse zbatohet plotësisht. - Për sa i takon ligjit për hapjen e dosjeve të ish -Sigurimit, të anketuarit shfaqin një tendencë
- gjinore: gratë kanë prirjen që të jenë më pak të informuara për aspektet e ndryshme të ligjit si edhe më pak të interesuara për ligjin dhe pasojat e tij.
- Rezultatet e anketës sugjerojnë që qytetarët nuk kanë interes personalisht lidhur me marrjen e informacionit nga dosjet e ish-Sigurimit. Sidoqoftë, një numër më i madh të anketuarish mendojnë që ky proces është i rëndësishëm për vendin (pavarësisht se nuk lidhet drejtpërsëdrejti me ta personalisht) dhe një pjesë e mirë e qytetarëve është e interesuar që të informohet për punën e autoritetit përgjegjës për hapjen e dosjeve.
- Lidhur me informacionin për regjimin e mëparshëm, të rinjtë kanë më pak informacion për tiparet e komunizmit shqiptar sesa ata në moshë më të madhe, gjë që pritet përderisa përvoja personale me atë regjim është burim i rëndësishëm informacioni. Gjithashtu, në tërësi, qytetarët në veri duket se janë më pak të informuar për regjimin e mëparshëm. Tiparet kryesore të jetës nën regjimin komunist kuptohen mirë, përgjithësisht. Publiku i gjerë nuk i njeh mirë të persekutoarit dhe duket se ka informacion të kufizuar për figurat publike të komunizmit.
- Televizioni ka rol shumë të rëndësishëm në dhënien e informacionit mbi të shkuarën, ndërkohë që duket se shkolla luan një rol tejet të kufizuar. Ndërkohë që shkollat janë përgjegjëse që t'u mësojnë historinë të rinjve, duket se ka shumë hapësira për ta fuqizuar rolin e tyre për të ofruar më shumë mësim për periudhën komuniste. Në punën lidhur me të shkuarën komuniste duhet të merret parasysh roli i qartë dominues i televizionit.
- Perceptimi për regjimin komunist nuk është një i vetëm dhe do të ishte e gabuar të supozohej që të gjithë shqiptarët e shohin komunizmin në të njëjtën mënyrë. Thujse gjysma e të anketuarve mendojnë se komunizmi në Shqipëri ishte "ide e mirë, por e zbatuar keq" (në të gjithë grupmoshat). Mbi një e treta e të anketuarve mendojnë se komunizmi ishte thjesht "de e keqe" sërish me shumë pak ndryshim nga grupmosha në grupmoshë. Vetëm 10% e të anketuarve shprehen se komunizmi në Shqipëri ishte "ide e mirë e zbatuar mirë" por numri i më të moshuarve që kanë këtë mendim pozitiv është dy herë më i madh sesa ai i të rinjve. Të para sipas rajoneve, rezultatet tregojnë që rajoni qendror (Tirana dhe Durrësi) kanë numrin më të madh të të anketuarve që mendojnë se komunizmi në Shqipëri ishte "ide e keqe" Numri më i madhe i qytetarëve që mendojnë se komunizmi në Shqipëri ishte 'ide e mirë e zbatuar si duhet' ishte në rajonin juglindor.


- Gjithashtu, perceptimi i jetës në komunizëm nuk është një i vetëm dhe shumica e njerëzve mendojnë se të paktën disa aspekte të jetës ishin më mirë në atë regjim, të tilla si siguria, arsimi dhe punësimi (si mundësitë për punësim, ashtu edhe kushtet e punës). Aspektet e jetës që njerëzit mendojnë se ishin më keq janë mungesa e lirisë, lufta e klasave dhe shkelja e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, të anketuarit janë të mendimit se zhvillimi ekonomik ishte më keq nën komunizëm.
- Shumica e qytetarëve mendojnë se gratë në shoqërinë shqiptare gjatë periudhës komuniste kishin rol më të dobët krahasuar me ditët e sotme, gjithsesi qytetarët shqiptarë kanë mendime të ndara lidhur me nëse gratë dhe burrat kishin të drejta të barabarta në arsim, punësim dhe fusha të tjera gjatë periudhës komuniste në Shqipëri.
- Roli i Enver Hoxhës në historinë e Shqipërisë shihet si pozitiv nga thujtse gjysma e qytetarëve, - por po aq e shohin rolin e tij si negativ. Sipas moshës, grupmosha 16-35 vjeç ka një mendim më të fortë negativ për kontributet e Enver Hoxhës krahasuar me grupmoshat e tjera. Të anketuarit nga rajoni jug/jugperëndimor janë ata që mendojnë më pozitivisht për Enver Hoxhën.
- Nuk ka një mendim të qartë të shumicës për rolin e Nexhmije Hoxhës; edhe mendimet për rolin e Ramiz Alisë në historinë e Shqipërisë janë të ndara. Gjithsesi, del që të anketuarit më të arsimuar kanë mendime më negative lidhur me rolin e Enver Hoxhës, Nexhmije Hoxhës dhe Ramiz Alisë.

Në tërësi, tabloja që del nga të dhënat është e ndërlikuar dhe rezultatet e ndara sipas kategorive janë shumë të rëndësishme, pasi theksojnë disa dallime të qarta në njohuri, perceptime dhe pritshmëri të popullsisë. Ndryshimet e rezultateve theksojnë më tej nevojën për një qasje shumëngjyrëshe dhe gjithëpërfshirëse ndaj punës për trajtimin e të shkuarës komuniste në Shqipëri.



00:00

00-00-00



Shtojcë



Vrojtim Social

ID. Numri serial	
QV. Qendra e Votimit	/
LOC. Qyteti/fshati [INT: shkruaj emrin e qytetit/fshatit]	
Qark. Qarku [INT: shkruaj emrin e Qarkut]	
LOCCODE. Kodi i qytetit/fshatit [INT shkruaj kodin e qytetit/fshatit të dhënë nga koordinatori]	
	d d m m
DM. Data e intervistës	
TS. Ora e fillimit të intervistës	h h m m
TE. Ora e mbarimit të intervistës	
TL. Kohëzgjatja e intervistës	
MET. Metodologjia (1=Random Route) (2=Kuote)	
REFUSALS. INT: Shkruaj numrin e refuzimeve të ndodhura për të kryer këtë pyetësor. Nëse nuk ka pasur refuzime shkruaj 0	
RESNAME. Emër Mbiemër i personit që ka dhënë intervistën	
RESNR. Numri i telefonit i personit që ka dhënë intervistën	
INTNAME. Emër Mbiemër i intervistuesit	
INTCODE. Kodi i Intervistuesit	
OPNAME. Emër Mbiemër i operatorit	

INTERVISTUES: LEXO FJALINË E MËPOSHTME:

Mirëmëngjesi/mirëmbërëma. Unë quhem _____ dhe punoj për kompaninë IDRA. Ne po zhvillojmë një ankete në lidhje me opinionin e qytetarëve për çështje të ndryshme ekonomike dhe sociale.

Familja juaj u përzgjedh në mënyrë rastësore. Do të doja t'ju siguroja se informacioni që ju do të ndani me ne do të mbetet tërësisht konfidencial. Emrat tuaj nuk do të shfaqen në asnjë dokument të kësaj ankete. Përgjigjet tuaja do të përdoren vetëm për qëllime analitike.

Së pari, do të doja të merrja disa informata në lidhje me përbërjen e familjes suaj. Me termin "familje" nënkuptojmë personat që zakonisht jetojnë së bashku, ndajnë të njëjtën banesë dhe kanë buxhet të përbashkët. Së pari, do më duhet të shkruaj emrin e kryefamiljarit, bashkëshortit/bashkëshortes së saj/tij, fëmijëve të tyre si edhe anëtarëve të tjerë të familjes.

A mund të më jepni informacionin e mëposhtëm?

Intervistues: Ju lutem plotësoni tabelën e mëposhtme me të gjitha informacionet e kërkuara për çdo anëtar të familjes. Mos përfshini vizitorët.

**INT. TREGO KUJDES TË MADH NË PËRGJIGJET E MËPOSHTME.
JANË BAZA E KAMPIONIMIT NË KËTË ANKETË!**

Plotëso:

R2. Sa persona banojnë këtu, në këtë familje?	
R3 Sa anëtarë të moshës mbi 16 vjeç ka familja juaj?	

SHTOJCË

Të dhënat demografike

Intervistues: Për të gjithë familjen kontrolloni pyetjet e mëposhtme:

Lidhja me kryefamiljarin							
Kodi	Gjinia 1. Mashkull 2. Femër	1. Kryefamiljar 2. Bashkëshort /partner 3. Fëmijë 4. Nip/mbesë (nga gjyshi, gjyshja) 5. Nip/mbesë (nga vëllai, motra) 6. Babai/nena 7. Motra/vëllai 8. Dhëndëri /nusja 9. Kunati / kunata 10. Gjyshi / gjyshja 11. Vjehrrri / vjehrra 12. I afërm tjetër 13. Pa lidhje familjare	Datëlindja			Moshë	
			dita	muaji	Viti		
R1	R2	R3	R4	R5	R6	Age	
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							

RESPCODE. Kodi i personit të përzgjedhur

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

A1 Në një shkallë nga 1 deri në 5 ku 1="Aspak i interesuar" dhe 5="Shumë i interesuar" sa të interesuar do të thoni se jeni për zhvillimet e mëposhtme në Shqipëri?

		Aspak të interesuar				Shumë të interesuar
A	Zhvillimet politike	1	2	3	4	5
B	Zhvillimet ekonomike	1	2	3	4	5
C	Zhvillimet shoqërore	1	2	3	4	5

A2 Sa problem mendoni se janë çështjet e mëposhtme sot në Shqipëri? [LEXO NGA LISTA]

		Aspak problem	Deri diku problem	Problem i madh	Nuk e di	
A	Edukimi Arsimi	1	2	3	4	5
B	Shëndetësia	1	2	3	4	5
C	Korrupsioni Keqqeverisja	1	2	3	4	5
A	Pandëshkueshmëria	1	2	3	4	5
B	Trashëgimia e së shkuarës komuniste	1	2	3	4	5
C	Ekonomia	1	2	3	4	5
B	Rendi Siguria	1	2	3	4	5
C	Terrorizmi Radikalizmi fetar	1	2	3	4	5
A	Ndotja e mjedisit	1	2	3	4	5

SHTOJCË

B1	Sa të informuar do të thoni se jeni për periudhën komuniste në Shqipëri?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shumë të informuar 2. Më së shumti të informuar 3. Më së shumti të painformuar 4. Nuk e di 			
B2	Sa të interesuar jeni për të mësuar më shumë rreth periudhës komuniste në Shqipëri?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aspak të interesuar 2. Më së shumti të pa interesuar 3. Më së shumti të interesuar 4. Shumë të interesuar 			
B3	<p>Nga cilat burime e merrni informacionin për të shkuarën komuniste të Shqipërisë? Ju lutem listoni burimet e parapëlqyera dhe renditni tre sipas rëndësisë.</p> <p>(Shënime për intervistuesin: a- Rretho secilin shërbim të përdorur, b- Rendit nga 1-3 sipas rëndësisë tre burimet kryesore, c- Shëno tre zgjedhjet kryesore që i anketuari përdor për tu informuar)</p>	Zgjidh burimin	Rendit 3 më të rëndësishmit		
		a. Burime të përdorura	B1. I pari	B2. I dyti	B3. I treti
A	Përvoja personale	A	1	1	1
B	TV	B	2	2	2
C	Libra	C	3	3	3
D	Gazeta	D	4	4	4
E	Shkolla	E	5	5	5
F	Internet	F	6	6	6
G	Bisedat me familjen, miq ose fqinj për të mësuar për të shkuarën komuniste të vendit	G	7	7	7
H	Burime të tjera të informacionit (specifik: _____)	H	8	8	8
I	Nuk jam aspak i interesuar për këtë çështje	I	9	9	9

B4	Si do ta vlerësonit punën e medias në Shqipëri, përsa i përket informimit të opinionit publik rreth të shkuarës komuniste në Shqipëri?	1. Shumë të mirë 2. Më së shumti të mirë 3. Më së shumti jo të mirë 4. Aspak të mirë 5. Nuk e di			
B5	Cila forma të informimit përmes medias, do të ishin më të përshtatshme për të rritur interesin e brezave të rinj për të shkuarën komuniste të Shqipërisë? [Zgjidh 2 përgjigje]	1. Filma 2. Dokumentarë historikë 3. Revista 4. Gazeta 5. Debate Televizive 6. Intervista me ish-figura publike të kohës 7. Tjetër (Specifiko) 9. Nuk e di			
B6	Ju lutem të më thoni nëse pohimet e mëposhtme janë të vërteta apo të gabuara:	E vërtetë	E gabuar	Nuk e di	
A	Në Shqipërinë komuniste, shteti garantonte punësim për të gjithë	1	2	9	
B	Shqiptarët mund të udhëtonin të lirë brenda vendit pa pasur nevojë për autorizim nga autoritetet përgjegjëse shtetërore	1	2	9	
C	Shqiptarët mund të lëviznin dhe të zhvendoseshin në një qytet/fshat tjetër brenda vendit pa pasur nevojë për autorizim nga autoritetet përgjegjëse shtetërore	1	2	9	
D	Shqiptarët kishin nevojë për një autorizim nga vendi i punës përpara se mund të blinin mobilje apo pajisje shtëpiake	1	2	9	
E	Në Shqipërinë komuniste shteti garantonte kujdes shëndetësor falas për të gjithë	1	2	9	
F	Shqiptarët në periudhën komuniste mund të udhëtonin lirisht jashtë shtetit kurdo ata dëshironin, pa ndonjë kufizim nga qeveria	1	2	9	
G	Shqiptarët në periudhën komuniste mund të blinin çdo të mirë të gjindshme në treg pa ndonjë kufizim	1	2	9	
H	Gjatë periudhës komuniste në Shqipëri, arsimi në nivelin universitar ishte i mundshëm për këdo që ishte i gatshëm ta ndiqte	1	2	9	
I	Shërbimi ushtarak në Shqipërinë komuniste ishte një zgjedhje personale dhe nuk ishte i detyruar nga shteti.	1	2	9	

B7

Cila nga strukturat/institucionet e listuar ishte përgjegjëse në vendimmarrje për sa i përket mundësisë së të rinjve për të ndjekur arsimin e lartë?

1. Byroja Politike
2. Këshilli Pedagogjik i Universitetit përkatës
3. Komiteti Ekzekutiv i Rrethit
4. Ministria e Arsimit
5. Partia e Punës
6. Nuk e di

B8

A mund të përmendni 3 anëtarë të byrosë politike në Shqipëri të cilët ishin ende në aktiv, pas ndryshimeve të vitit 1990, në Shqipëri?

1. _____
2. _____
3. _____

B9

Në një shkallë nga 1 deri 5, ku 1="Nuk kam asnjë informacion" dhe 5="Di shumë për të", a mund të na thoni se sa informacion keni për secilën nga figurat publike të periudhës komuniste në Shqipëri të listuar më poshtë:

B6

Ramiz Alia

Asnjë informacion

Di shumë për të

A

Nexhmije Hoxha

1

2

3

4

5

B

Mehmet Shehu

1

2

3

4

5

D

Adil Carcani

1

2

3

4

5

E

Beqir Balluku

1

2

3

4

5

F

Liri Belishova

1

2

3

4

5

B10

A mund të më thoni se cili prej këtyre personave ishte kryeministri i fundit i periudhës komuniste në Shqipëri?

- 1.Ramiz Alia
- 2.Mehmet Shehu
- 3.Adil Carcani
- 4.Beqir Balluku
- 5.Nuk e di

B11

Bazuar në informacionin tuaj, a ishin personat e mëposhtëm të persekutuar nga regjimi komunist në Shqipëri?

B6		Po	Jo	Nuk e di
A	At Zef Pllumbi	1	2	3
B	Manush Myftiu	1	2	3
C	Pjeter Arbnori	1	2	3
D	Sabihe Kasimati	1	2	3
E	Pali Miska	1	2	3
F	Petro Marko	1	2	3
G	Jusuf Vrioni	1	2	3

B12	Në cilin vit ka vdekur Enver Hoxha?	<ol style="list-style-type: none"> 1. 1975 2. 1981 3. 1985 4. 1988 5. Nuk e di
B13	Sipas njohurive tuaja, a ka qene Shqipëria ndonjëherë pjesë e Paktit të Varshavës?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Po 2. Jo [Kalo tel B15] 3. Nuk e di
B14	Në cilin vit doli Shqipëria nga Pakti i Varshavës? [Lexo alternativat]	<ol style="list-style-type: none"> 1. 1952 2. 1961 3. 1968 4. 1974 5. 1980 6. Nuk e di
B15	Sipas informacionit tuaj, sa anëtarë kishte Partia e Punës gjatë periudhës komuniste në Shqipëri?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Midis 40.000-60.000 anëtarë 2. Midis 60.000- 80.000 anëtarë 3. Midis 80.000- 100.000 anëtarë 4. Midis 100.000- 200.000 anëtarë 5. Më shumë se 200.000 anëtarë 6. Më shumë se 500.000 anëtarë 7. Nuk e di
B16 Skenari 1	Një qytetar i thjeshtë në Shqipërinë komuniste dëshiron të blejë një TV të ri. Për të bërë këtë, atij/asaj i:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nevojitej të merrte një leje nga autoritetet mbikëqyrëse në vendin e tij/të saj të punës 2. Nevojitej të merrte leje nga Partia e Punës 3. Mund të blinte lirisht TV nëse mund ta përballonte 4. Nuk e di
B17 Skenari 2	Një familje tipike në Shqipërinë komuniste gjatë viteve 80, planifikon të blejë sasinë e nevojshme të ushqimeve në treg. Supozojmë së kjo familje i ka mundësitë financiare për të blerë të gjithë sasinë e ushqimeve që i nevojitet për konsum bazuar në numrin e anëtarëve. Në një rast të tillë, kjo familje:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mund të blejë të gjithë sasinë e nevojshme të produkteve që gjenden në treg, duke paguar çmimet përkatëse, pa pasur kufizime nga autoritetet shtetërore. 2. Duhet të pajiset me autorizim nga autoritetet shtetërore për të blerë sasinë e produkteve që dëshiron, pa kufizime. 3. Duhet të pajiset me autorizim nga autoritetet shtetërore, të cilat kufizojnë sasinë e produkteve që kjo familje mund të blejë. 4. Nuk e di

C1	Sipas mendimit tuaj, komunizmi në Shqipëri:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ishte një ide e gabuar 2. Ishte një ide e mirë, por e zbatuar keq në praktikë 3. Ishte një ide e mirë e zbatuar mirë në praktikë 4. Nuk e di
C2	<p>A mund të më thoni 3 aspektet më pozitive të periudhës komuniste në Shqipëri sipas jush?</p> <p>(SHKRUAJ PËRGJIGJEN E TË INTERVISTUARIT DHE MË PAS KODO SIPAS MUNDESIVE TË LISTUARA)</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Siguria në punë 2. Garantimi i jetesës së përditshme 3. Barazia gjinore 4. Shteti i së drejtës 5. Shërbim i mirë shëndetësor 6. Sistemi arsimor 7. Barazia shoqërore 8. Rendi publik 9. Mjedisi i pastër 10. Asgjë pozitive 11. Nuk e di
C3	<p>A mund të më thoni 3 aspektet më negative të periudhës komuniste në Shqipëri sipas jush?</p> <p>(SHKRUAJ PËRGJIGJEN E TË INTERVISTUARIT DHE MË PAS KODO SIPAS MUNDESIVE TË LISTUARA)</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mungesa e lirisë 2. Lufta e klasave 3. Dhunimi i të drejtave të njeriut 4. Varfëria 5. Pamjaftueshmëria e ushqimit dhe produkteve të tjera 6. Diktatura si regjim politik 7. Prania e një klime terrori 8. Feja 9. Kufizimet në arsim 10. Koletivizimi 11. Asgjë negative 12. Nuk e di
C4	Sipas mendimit tuaj, kushtet e jetesës gjatë periudhës komuniste në Shqipëri ishin:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Më mirë se sa sot 2. Të njëjta 3. Më keq se sot 9. Nuk e di
C5	Sipas mendimit tuaj, krahasuar me ditët e sotshme, gratë në shoqërinë Shqiptare gjatë periudhës komuniste të vendit kishin një rol:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Më të rëndësishëm 2. Të njëjta 3. Më të dobët 4. Nuk e di
C6	Bazuar në njohuritë tuaja, gjatë periudhës komuniste në Shqipëri, a kishin burrat dhe gratë të drejta të barabarta në arsim, punësim etj.?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Po 2. Jo 3. Nuk e di

SHTOJCË

C7	Me cilin prej pohimeve të mëposhtme jeni dakord? Shqipëria në kohën e komunizmit:	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	Nuk e di
A	Ishte më e sigurt se sot	1	2	3	4	9
B	Kishte arsim dhe edukim më cilësor sesa ditët e sotshme	1	2	3	4	9
C	Ofronte më shumë mundësi punësimi krahasuar me ditët e sotshme	1	2	3	4	9
D	Ofronte më shumë siguri në punë se sot	1	2	3	4	9
E	Ishte më e qëndrueshme politikisht krahasuar me ditët e sotme	1	2	3	4	9
F	Ishte më pak e korruptuar krahasuar me ditët e sotme	1	2	3	4	9
G	Kishte më shumë barazi të standardeve të jetesës krahasuar me ditët e sotshme	1	2	3	4	9
H	Kishte një jetë më të rehatshme krahasuar me ditët e sotme	1	2	3	4	9
I	Kishte zhvillim ekonomik më të mirë se sot	1	2	3	4	9
J	Ishte më mirë për lirinë e shprehjes se krahasuar ditët e sotme	1	2	3	4	9
K	Përgjithësisht më mirë se sot	1	2	3	4	9

C8	Cili është mendimi juaj për rolin e Enver Hoxhës në historinë e vendit?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Enver Hoxha ka pasur ndikim pozitiv në historinë e Shqipërisë 2. Enver Hoxha nuk ka pasur ndikim në historinë e Shqipërisë 3. Enver Hoxha ka pasur një ndikim negativ në historinë e Shqipërisë 4. Refuzoj të përgjigjem 5. Nuk e di
C9	Cili është mendimi juaj personal për rolin e Nexhmije Hoxhës në historinë e vendit?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nexhmije Hoxha ka pasur ndikim pozitiv në historinë e Shqipërisë 2. Nexhmije Hoxha nuk ka pasur ndikim në historinë e Shqipërisë 3. Nexhmije Hoxha ka pasur një ndikim negativ në historinë e Shqipërisë 4. Refuzoj të përgjigjem 5. Nuk e di
C10	Cili është mendimi juaj personal për rolin e Ramiz Alisë në historinë e vendit?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ramiz Alia ka pasur ndikim pozitiv në historinë e Shqipërisë 2. Ramiz Alia nuk ka pasur ndikim në historinë e Shqipërisë 3. Ramiz Alia ka pasur një ndikim negativ në historinë e Shqipërisë 4. Refuzoj të përgjigjem 5. Nuk e di
D1	<p>Gjatë periudhës komuniste në Shqipëri, a keni qenë ju personalisht:</p> <p>[Pyet vetëm nëse mosha e të anketuarit > 50] [Lexo alternativat] [Me shumë se 1 përgjigje]</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. I burgosur 2. I internuar 3. I persekutuar politikisht 4. Asnjëra prej këtyre 8. Refuzoj të përgjigjem
D2	<p>Gjatë periudhës komuniste në Shqipëri a ka pasur pjesëtarë nga rrethi juaj i ngushtë familjarë (prindër, motra, vëllezër):</p> <p>[Lexo alternativat] Me shume se 1 përgjigje]</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të burgosur 2. Të internuar 3. Të ekzekutuar 4. Asnjëra prej këtyre 5. Nuk e di
D3	<p>Gjatë periudhës komuniste në Shqipëri a ka pasur pjesëtarë nga rrethi juaj i gjerë familjarë (xhaxha/dajë, hallë/teze, gjysh/gjyshe, kushërinj të brezit të parë):</p> <p>[Lexo alternativat] [Më shumë se 1 përgjigje]</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të burgosur 2. Të internuar 3. Të ekzekutuar 4. Asnjëra prej këtyre 5. Nuk e di

D4	<p>PYET NËSE mosha e të anketuarit = ose > 50 vjeç(e) Gjatë periudhës komuniste në Shqipëri a ishit ju:</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Anëtar i Partisë së Punës 2. Anëtar i Komitetit Qendror 3. Asnjëra prej këtyre 8. Refuzoj të përgjigjem
D5	<p>PYET NËSE MOSHA e të anketuarit < 50 vjeç(e) Gjatë periudhës komuniste në Shqipëri, a ishte ndonjë nga prindërit tuaj:</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Anëtar i Partisë së Punës 2. Anëtar i Komitetit Qendror 3. Asnjëra prej këtyre 8. Refuzoj 9. Nuk e di
D5	<p>Të ardhurat familjare në Shqipërinë komuniste, bazuar në standardin e kohës</p>	
<p>Në një shkallë nga 1 deri 10, ku 1="Shumë poshtë" dhe 10="Shumë lartë", si do ti cilësonit të ardhurat e familjes suaj gjatë periudhës komuniste në Shqipëri, krahasuar me standardet ekonomike të kohës?</p> <p style="text-align: center;">Shumë të ulëta Shumë të larta</p> <p style="text-align: center;">← 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 →</p>		
E1	<p>A jeni në dijeni të ndonjë ligji të miratuar së fundi për të drejtën e publikut për t'u informuar për dosjet sekrete të ish-Sigurimit të shtetit në Shqipëri?</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Po 2. Jo 9. Nuk e di
E2	<p>[PYET NËSE E1=1] Sa i informuar mendoni se jeni për këtë ligj (REF E1)? [Lexo alternativat]</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aspak i informuar 2. Jo shumë i informuar 3. Disi i informuar 4. Shumë i informuar 5. Nuk e di

E3	Cila nga këto pohime vlen për ju personalisht? [Lexo alternativat]	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkoj qëllimisht informacion për zhvillimet që lidhen me dosjet sekrete të ish-Sigurimit të Shtetit në Shqipëri 2. Kërkoj rastësisht informacion për zhvillimet që lidhen me dosjet sekrete të ish-Sigurimit të Shtetit në Shqipëri 3. Nuk jam aspak i interesuar për zhvillimet që lidhen me dosjet sekrete të ish-Sigurimit të Shtetit në Shqipëri 8. Refuzoj të përgjigjem
E4	A e keni lexuar ligjin e miratuar së fundi për hapjen e dosjeve sekrete të Ish-Sigurimit të Shtetit në Shqipëri? [Lexo alternativat]	<ol style="list-style-type: none"> 1. Po 2. Jo
E5	Në çfarë mase e kundërshtoni apo e mbështesni këtë ligj? [Lexo alternativat]	<ol style="list-style-type: none"> 1. E mbështes fuqimisht 2. E mbështes deri diku 3. E kundërshtoj deri diku 4. E kundërshtoj fuqimisht 5. Nuk kam informacion të mjaftueshëm për ligjin për të dhënë mendim 9. Nuk e di/refuzoj të përgjigjem
E6	Cili mendoni se është qëllimi kryesor i këtij ligji? [Lexo alternativat]	<ol style="list-style-type: none"> 1. Publiku informohet për dosjet sekrete të ish-Sigurimit të Shtetit 2. Ngritja e një arkivi historik të përshtatshëm me dokumente nga periudha komuniste në Shqipëri 3. T'u japë mundësi viktimave të ish- Shërbimit Sekret të gjejnë të dhëna për informatorët që i kanë raportuar 4. Nuk e di
E7	Nga e keni marrë kryesisht informacionin për këtë ligji? [Lexo alternativat]	<ol style="list-style-type: none"> 1. TV 2. Gazeta 3. Internet 4. Revista 5. Biseda me miq/familje 6. Media sociale 7. Nuk jam përballur me ndonjë informacion të lidhur me këtë ligj
E8	Cila nga këto pohime lidhur me hapjen e dosjeve sekrete të komunizmit në Shqipëri vlen për ju personalisht?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Tema mbi dosjet nuk më ka interesuar kurrë (as më herët, as tani) 2. Më herët kam qenë i interesuar për temën e dosjeve, por tani nuk jam më i interesuar 3. Nuk kam qenë i interesuar më herët për temën e dosjeve, por tani jam i interesuar 4. Kjo temë më ka interesuar gjithnjë (më herët dhe tani)

		Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	Nuk e di
E16	A pajtoheni me pohimet e mëposhtme?					
A	Ndërtimi i një arkivi të konsoliduar të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit është i rëndësishëm për historinë e vendit tonë	1	2	3	4	9
B	Figurat publike aktuale, të cilat janë zbuluar se kanë qenë pjesë e shërbimit sekret komunist duhet të japin dorëheqje nga pozicioni i tyre	1	2	3	4	9
C	Informacioni për të gjitha lidhjet e figurave publike aktuale me ish-Sigurimin e Shtetit në Shqipëri duhet të bëhet publik	1	2	3	4	9
D	Bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit në Shqipëri nuk duhet të kenë të drejtë të mbajnë poste publike	1	2	3	4	9
E	Shumica e dosjeve të Ish-Sigurimit të Shtetit tashmë janë ndryshuar apo asgjësuar nga personat e interesuar, gjë që e bën publikimin e tyre të padobishëm.	1	2	3	4	9
F	Përfshirja e figurave publike aktuale në shërbimet sekrete komuniste duhet të konsiderohet si pjesë e së shkuarës dhe nuk duhet të ketë ndikim në karrierat e tyre	1	2	3	4	9
G	Hapja e të gjitha dosjeve sekrete të lidhura me ish-Sigurimin e Shtetit në Shqipëri është një kërcënim për sigurinë kombëtare dhe për rrjedhojë nuk duhet të bëhet	1	2	3	4	9

		Nuk besoj aspak					Besoj plotësisht				
A	Qeverisjes vendore (bashki)	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
B	Partive politike	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
C	Kontrollit të Lartë të Shtetit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
D	Gjyqësorit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
E	Avokatit të Popullit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
F	Prokurorisë së Përgjithshme	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
G	Kryeministrit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
H	Policisë	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
I	Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
J	Presidentit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
K	Parlamentit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
L	Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKP)	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
M	Liderëve të komuniteteve fetare	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

F2	A pajtoheni me pohimet e mëposhtme?	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	Nuk e di
A	Ka disa aspekte të periudhës komuniste që duhet të njihen nga brezat e rinj	1	2	3	4	9
B	Shqiptarët meritojnë një shfajësim zyrtar për persekutimin dhe padrejtësinë e vuajtur nën regjimin komunist përpara se të ecim përpara.	1	2	3	4	9
C	E shkuara komuniste e Shqipërisë duhet të shërbejë si një shembull për rëndësinë e barazisë shoqërore, vullnetarizmit civil dhe të një rritjeje të sensit të komunitetit për brezat e rinj	1	2	3	4	9
D	Një numër i konsiderueshëm politikanësh në Shqipëri sot kanë mbajtur pozicione të rëndësishme gjatë periudhës komuniste prandaj nuk duhet lejuar të jenë deputetë, politikanë, apo zyrtarë të administratës publike etj.	1	2	3	4	9
E	E shkuara komuniste e Shqipërisë është një periudhë e tmerrshme, e cila duhet të harrohet tërësisht dhe të mos i mësohet gjeneratës së re	1	2	3	4	9

F3	Në çfarë mase i mbështesni nismat e mëposhtme?	Mbështes fort	Mbështes disi	Kundërshtoj disi	Kundërshtoj fort	Nuk e di
A	Ngritjen e një Muzeu Kombëtar për diktaturën komuniste	1	2	3	4	9
B	Hartimin dhe zbatimin në të ardhmen të një ligji për largimin e zyrtarëve publikë, të cilët kanë qenë bashkëpunëtorë të Ish-Sigurimit të Shtetit.	1	2	3	4	9

F4	Çfarë mendon se duhet bërë sot me ish vendet/zonat e persekutimit në Shqipëri?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nuk duhet bërë asgjë 2. Duhet t'i ruajmë ato për gjeneratat e ardhshme 3. Duhet t'i shkatërrojmë ato për të fshirë të shkuarën komuniste 9. Nuk e di
----	--	--

F5	Autoriteti përgjegjës për rihapjen e dosjeve sekrete të Sigurimit në Shqipëri zbulon se një zyrtar publik shumë i rëndësishëm ka qenë pjesë e Shërbimit Sekret. Çfarë mendoni duhet të ndodh në këtë rast: [Lexo alternativat]	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zyrtari(ja) publik(e) duhet të japë dorëheqjen 2. Institucioni ky ai/ajo punon duhet ta largojë atë edhe nëse zyrtari(ja) nuk jep dorëheqjen 3. Nuk duhet të ndodhë asgjë. E shkuara e tij/saj komuniste nuk ka rëndësi për punën e tij aktuale 4. Nuk e di
----	---	---

F5_1	Të supozojmë se ky informacion bëhet publik nga media. Cilat nga alternativat e mëposhtme mendoni se është më e mundshme të ndodhë? [Lexo alternativat]	<ol style="list-style-type: none"> 1. Informacioni injorohet plotësisht nga autoritetet 2. Hapet një hetim por ai nuk arrin asnjëherë në konkluzion 3. Zyrtari publik shkarkohet nga posti që mban dhe i hiqet e drejta për të qenë pjesë e administratës publike në të ardhmen 4. Nuk e di
------	--	---

F6	<p>Një zyrtar/e i/e lartë me ndikim , ndërhyr në punën e Autoritetit përgjegjës për hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit, duke synuar të mos lejojë hapjen dhe publikimin e dokumenteve rreth tij/saj/: Sipas jush, në një situatë të tillë: [Lexo alternativat]</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Autoriteti përgjegjës për hapjen e dosjeve tërhiqet përpara presionit të zyrtarit të lartë, duke mbajtur të fshehur identitetin e tij . 2. Autoriteti përgjegjës i reziston trysnisë së zyrtarit dhe vijon punën për përpunimin e dosjeve rreth tij 3. Autoriteti përgjegjës denoncon ndërhyrjet e zyrtarit të lartë në punën e tij dhe zyrtari ndiqet penalisht.Nuk e di
F6_1	<p>Të supozojmë se ky informacion bëhet publik nga media Cilat nga alternativat e mëposhtme mendoni se është më e mundshme të ndodhë? [Lexo alternativat]</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Informacioni injorohet plotësisht nga autoritetet 2. Hapet një hetim por ai nuk arrin asnjëherë në konkluzion 3. Zyrtari publik shkarkohet nga posti që mban dhe i hiqet e drejta për të qenë pjesë e administratës publike në të ardhmen 9. Nuk e di
F7	<p>Një ish kamp i punës së detyruar nga periudha komuniste ndodhet afër një burimi mjaft të çmuar të mineraleve. Një kompani private dëshiron të rihapë minierën në një pjesë të këtij ish-kampi të punës së detyrueshme. Çfarë mendoni se duhet të ndodhë në një rast të tillë? [Lexo alternativat]</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ruajtja e historisë së objektit është prioriteti kyç, ndaj kompania nuk duhet të lejohet të punojë në këtë kamp. 2. Përfitimet ekonomike nga miniera janë prioriteti kryesor, kështu që kompania duhet të lejohet të punojë kudo në zonën e ish-kampit pa kufizime. 3. Kompania duhet të lejohet të punojë në zonën e ish kampit, por me disa kufizime në mënyrë që të mund të ruhet historia e ish kampit të punës. 9. Nuk e di

osce Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

 **Ambasada
e Republikës Federale të Gjermanisë
Tiranë**

idra 



978-92-9235-274-5